

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

VEPRA

VËLLIMI I PARË



PRISHTINË, 2013

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
SECTION OF LITERATURE AND LINGUISTICS

Ali Podrimja

WORKS

I

Editorial board:

Ali Aliu, editor
Rexhep Ismajli
Eqrem Basha
Sabri Hamiti
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

VEPRA

VËLLIMI I PARË

Redaksia:

Ali Aliu, redaktor përgjegjës
Rexhep Ismajli
Eqrem Basha
Sabri Hamiti
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013



NJË ZË THELLËSISHT TRONDITËS DHE I MPREHTË, BARTËS I DHEMBJES SË TË GJITHËVE

Sbëkruhet vetëm një libër i vetëm. Çdo sbëkrimtar e sbëkruan librin e tmerrshëm në të cilin e derdh tërë jetën e vet. Dukuritë suksesive nga fragmenti në fragment, përherë i plotësojnë, krijojnë konvergencat e ndryshme të kapitujve.

Ali Podrimja

I.

Pothuaj që me lindjen, në fillim të viteve dyzet të shekullit të kaluar, Ali Podrimja zhvillon një betejë dramatike të pasosur: janë fati dhe fatkeqësitë kolektive dhe intime me të cilat do të përballëtohet gjatë tërë jetës poeti i shquar shqiptar. Që herët do të mbetet jetim, pa nënën edhe pa babanë. Por jetim do të mbetet edhe karshi Kosovës së vet të lindjes, e cila ashtu siç e pa dhe e gjeti si fëmijë dhe të atillë që e përcollti deri në fund të shekullit, do të jetë nën terror të pandërprerë, nën masakrat e pushtuesit të huaj. Dhe në këtë kontekst të fatit të vet dhe atij kosovar, poetin do ta godasë edhe fatkeqësia e quajtur Lumi-biri, të cilin ia rrëmbeu vdekja në moshën e re. Përballë këtij mozaiku të fatit kosovar

dhe podrimjan, poeti Ali Podrimja do të zhvillojë një luftë stoike, me vullnet të ndezur, duke i përballuar të gjitha goditjet e fatit individual dhe kolektiv. E tërë poezia e tij, në fakt, bart në vete shqetësimin, dramën, tragjizmin e këtij fati, duke u artikulluar si art majash në letërsinë bashkëkohore shqiptare, si art poetik që çan rrugë dhe pranohet si vlerë universale. Ky bard poetik i Kosovës, si një variant i veçantë, në mënyrë të vet, simbolizon më shumë gjenerata poetike shqiptare.

Në lartësinë e vet artistike poezia e Ali Podrimjes shkëlqen misionare: poeti që nga fillimet ka gjakuar të jetë zë i dhembjes kolektive kosovare, vizion që mund të konsiderohet edhe si një ndërmarrje donkishoteske e llojit të vet, e zëri i tij poetik do të jetë thellësisht tronditës, i mprehtë, i qëndrueshëm, bartës i dhembjes së të gjithëve. Prandaj poezia e tij, e përcaktuar, e lindur në valët e këtij shqetësimi dhe misioni nuk do të jetë në asnjë rrethanë një lament dëshpërues, i pashpresë i vuajtjes dhe dhimbjes, por përkundrazi, vargu i tij do të jetë mobilizues në drejtim të mbrojtjes së frymës, do të jetë një mburojë e shpirtit kolektiv gjatë vuajtjeve epokale të popullit të vet dhe poezi pa të cilën vuajtja dhe dhembja do të ishin më tragjike, të pashpresa dhe absurde. Ali Podrimja si poet kërkon dhe zbulon sferat, shtyllat mbajtëse më vitale brenda këtij oqeani vuajtjesh, duke shpalosur në artin e vet poetik burimet e shpresës dhe qëndresës.

II.

Poetët të cilët ndihen përgjegjës, përkatësisht poetët të cilët marrin mbi vete rolin e një lloj demiurgu, në të vërtetë poetët të cilët lindin të paracaktuar për një rol të tillë, vizionarë dhe rapsodë, tërë qenien e tyre, tërë forcën dhe energjinë, e gjithë kohën në dispozicion e shndërrojnë absolutisht në një mision të tillë. Këta poetë, ashtu siç përshkruan Neruda luftëtarin Bolivar *çdo njëqind vjet*, atëherë kur i thërret populli; një rol dhe përcaktim i tillë mund t'i përshkruhet edhe poetit të madh të

Kosovës Ali Podrimja, përballë fatit kolektiv kosovar dhe shqiptar.

Impulset e para poetike, përkatësisht gjenin e lindur krijues Ali Podrimja do ta ndiejë që në moshën e tij të re, sidomos me shtatëmbëdhjetë vjetët e mbushur, kur do t'i botojë vargjet e para në revistën me reputacion letrar të kohës *Jeta e re*, revistë të cilën me një ngrohtësi dhe takt prindëror ndaj krijuesve të rinj asokohe e udhëhiqte poeti i madh dhe humanisti i shquar shqiptar Esad Mekuli. Dhe është fare e natyrshme që Ali Podrimja do të frymëzohej edhe nga kodi etik sidomos i Esad Mekulit, por me rëndësi është të theksohet se përmes poezisë së Esad Mekulit ai do ta ndiejë përgjegjësinë historike, ndjenjën për të qenë përgjegjës për fatin kolektiv kosovar. Natyrisht, në këto fillime nuk ishte e lehtë të ecej gjurmëve, përkatësisht të vazhdohej dhembja poetike e pranishme në lirikën sociale të Esad Mekulit. Edhe për një gjë të tillë, në moshën më të njomë, poetit Ali Podrimja i duhej mbështetja e iluzionit donkishotesk, i duhet mbështetja për të qenë më i fuqishëm për ta mposhtur realitetin tragjik. Shenjat e para të trashëguara nga gjenerata në gjeneratë poetësh kosovarë, që do ta sfidojnë që në hapat e parë krijues Ali Podrimjen, ishte fjala që paralajmëronte ndalesën: mos, ishte fjala e ndaluar - miti i ndaluar, personazhet e ndaluara të rrëfimeve, këngët e ndaluara, historia e ndaluar, bukuria e ndaluar. Sfidat e nxitura nga këto ndalesa do të bëjnë që Ali Podrimja gjatë viteve pesëdhjetë të shekullit XX të përjashtohet nga bankat e gjimnazit të Gjakovës. Që me vargjet e para ai i shqetësoi shpirtat e rojtarëve të “rendit”.

Që në vitet e para të jetës, Ali Podrimja do të ndeshet me një realitet brutal, përkatësisht që në ditët e para që futet në jetë ai do të rrëmbehet nga zemërimi e revolta dhe ndonëse i vetmuar dhe pa ndihmën e askujt, do të vazhdojë ta shprehë shqetësimin shpirtëror, do të refuzojë fuqishëm nga brenda, të cilin nuk do të mund ta heshtin mullinjët dhe stuhitë e egra. I ndërgjegjshëm për përcaktimin e brendshëm, për misionin e madh të cilit tërësisht i dorëzohet, me guxim dhe dinjitet, Ali Podrimja është plotësisht i

vendosur dhe i sigurt për sa dëshiron, për sa beson, për misionin e vet, duke e artikuluar tërë atë revoltë përmes zërit poetik të fuqishëm që sa vjen e pushton hapësirën shqiptare. Në njëzet e më shumë vëllime poetike, por edhe në disa vëllime funksionale eseistike – në frymën gjithnjë të poezisë së tij, ai do t'i prekë dhe do t'i përvijojë majat e poezisë shqipe. Në një hark kohor prej gjysmë shekulli, Ali Podrimja do t'i qëndrojë besnik projektit madhor poetik. Brenda këtij projekti ai do ta vijëztojë edhe synimin kolektiv: do të jetë rapsodi i madh shqiptar, ai i zërit të këngës integrale në kohë dhe hapësirë, zë i të gjitha të pathënave shqiptare gjatë shekujve të kaluar, i shekujve të durimit dhe heshtjes. Ai, i magjepsur pas imagjinatës së vet, deri në fund do të gjakojë pas kodit poetik mitik të ilirëve dhe arbërve, të kënduar si një palimpsest në *Gur* dhe *Kullë*, në Kalanë e Rozafës në tregimet mbi Ujkun dhe verojkat, në Gjarprin helmues të shtëpisë, në mjeshtërit e Urës, i betuar dhe i përbetuar se Kosova është gjak që nuk falet...

III.

Pesha e projekti të madh të Ali Podrimjes qëndron në ngasjen dhe klithjen e brendshme të thellë të artikuluar mjeshtërisht kundër çdo gjëje që e shëmton, që e degradon bukurinë në jetë dhe në njeriun, kundër çdo gjëje që e dehumanizon botën. I tillë do të mbetet Ali Podrimja, qiellor dhe tokësor, edhe atëherë kur do të përballet me goditjen më tragjike të mundshme për njeriun, me sëmundjen e pashërueshme të të birit, Lumit. Poeti, kësaj here, si baba, me zemër dhe shpirt të plagosur, do të niset rrugës së përballimit të goditjes dhe do ta ndajë dhembjen dhe betejën për jetë së bashku me të birin. Ndërsa sëmundja mizore, sunduese, sovrae, si një kërcënim fatal mbi jetën e më të dashurit, penetron tinëzisht dhe mortërisht nëpër trupin e tij, poeti do të përballet me një luftë të paparë duke e pranuar vdekjen si sfidë dhe duke i bërë bashkë në qenien e tij edhe Prometeun dhe Don Kishotin. Me një instinkt të paparë

prindëror, instinkt dhe ndjenjë që e refuzon vdekjen deri në momentin kur jeta vazhdon të pulsojë edhe me atomin e fundit, Ali Podrimja me birin ndër qafë do të bredhë duke kërkuar shërim për trupin dhe shpirtin e pjellës së vet nëpër shumë kryeqytete të Evropës.

Ali Podrimja është krijuar i dy të vetmeve poetika: njëra është personalja “Poetika e jetës” dhe tjetra është “Poetika e fjalës”. Të dy poetikat përbëjnë një lament tragjik të jetës, të universit dhe të fjalës poetike. Poetët e mëdhenj, gjatë historisë njerëzore sikur të jenë të paracaktuar për të qenë viktimë të zgjedhura, për të qenë “në shërbim” të ndjenjës tragjike në jetë. Edhe Ali Podrimja është një nga “të zgjedhurit e mallkuar”. Këtë linjë të ndjeshmërisë tragjike të botës dhe jetës poeti ynë do ta pranojë që në moshë të re në Kosovën e tij të lindjes, kur fillon shpërngulja, çrrënjësja më dramatike e popullatës shqiptare kosovare drejt emigrimit, nën dhunën mizore të regjimit serb, sidomos në periudhën e fushatës famëkeqe të UDB-së nën emrin mbledhja e armëve dhe syrgjynosjes së madhe të shqiptarëve drejt Anadollit turk. Ankesa e tij e fuqishme poetike, e njëkohësisht edhe në shenjë revolte dhe mospajtimi, do të përvidhet, do të pulsojë në vargjet e tij të para si kundërvënie kësaj çrrënjësjeje tragjike: “*Qaj rrafshi im i dashur, qaj*” (Rrafshi i Dukagjinit)... Ky vaj do të jetë karakteristikë e poetit të madh shqiptar si vaj i revoltës dhe shpresës, i qëndresës përmes së cilës do të shënohet fati historik i një populli i lënë në mëshirën e fatit. Është me rëndësi të theksohet se në jetëshkrimin e tij për këtë vijëzim tragjik, në librin me poezi “Lum Lumi”, Ali Podrimja e artikulon rilindjen e vet prometeike, përmes *universit të fjalës*. Me këtë rast dhembja është përjetësuar, është e prekshme, e përjetshme. Me intensitetin emotiv të brendshëm të fuqishëm në krahët e dialogut mes jetës dhe vdekjes, Ali Podrimja tërheq, zbulon filozofinë e ekzistencës së vet “*të jetosh, do të thotë të mësosh si vdisel!*” Një ndjenjë e tillë madhore e Ali Podrimjes gjithsesi se rrjedh nga përvoja e ekzistencës me të cilën ai ballafaqohet pothuaj në të gjitha fazat e krijimtarisë së vet dhe me të gjitha mësimet e urta për vdekjen

dinjitoze. Ndërkaq, fuqia poetike e Ali Podrimjes nuk mbështetet vetëm në ndjenjën individuale lidhur me pranimin dhe kuptimësinë e tragjizmit në jetë, por ai, me një ndjenjë të jashtëzakonshme solidare me fatin e popullit të vet, arrin të zbulojë horizontet e arketipit të popullit të vet, ta shkrijë fatin e vet në atë kolektiv, t'ia bartë atij fati shenjën e fuqishme individuale. Ai në këtë rrugë të mundimshme mes tragjizmit personal dhe kolektiv do të mbërrijë të vërvitet në majat e poezisë shqiptare duke vazhduar të mbetet si një talent i jashtëzakonshëm, si zë më i fuqishëm në të gjithë hapësirën shqiptare, duke u përfshirë kështu si vlerë e rëndësishme universale. Prandaj, Ali Podrimja aktualisht është poeti shqiptar më i përkthyer në botë: i përkthyer në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, polonisht, hungarisht, suedisht, rusisht, turqisht, kroatisht etj. Ai është bartës i çmimeve të larta poetike. Është laureat i çmimit ndërkombëtar prestigjioz për poezi “Nikolaus Lenau” në Gjermani...

IV.

Ekziston një raport mes poetit dhe kolektivitetit të cilit ai i takon (përkatesisht identitetit nga i cili vjen), raport që është tejet kompleks, i paparashikueshëm, por pa të cilin poeti do ishte i mangët nga motivet vendimtare për mbështetje dhe qëndresë të ekzistencës së vet krijuese në kohë, por edhe në përgjithësi në përjetësinë letrare. Ky raport mes poetit dhe kolektivitetit për të cilin shkruan, i cili e përcakton, e lind, e paracakton, shpesh vjen përmasash reale, por më shpesh vjen edhe përmes përmasave mitike: poeti në këtë rast merr mbi shpatulla misionin prometeik – që në çastin e duhur t'i thotë fjalët e duhura të popullit të vet, të origjinës së vet. Shpesh ky relacion mes poetit dhe popullit shndërrohet në një përgjegjësi mitike për vetë poetin. Me këtë rast, ai e kalon natyrshëm, lehtësisht, me një vrull donkishotesk rubikonin e iluzioneve. Populli, ndërkaq, e zbulon, e rinjeh Don

Kishotin e vet, i cili në veprën artistike e gjen kodin e ekzistencës, të qëndresës së vet kolektive nëpër vuajtje dhe rezistencë.

Në mbrojtje të fisit të vet, Ali Podrimja do ta trashëgojë lamentin e vuajtjeve edhe të të parëve të tij të largët, por edhe të afërt, do ta përjetojë edhe vetë terrorin e egër, duke arritur që pikërisht në këto kushte t'i zbulojë izohipsat e përbashkëta të tragjizmit, t'i përcaktojë metaforat kryesore për një dalje të mundshme figurative.

Poezia e Ali Podrimjes e mban të gjallë shpresën se dalja nga ferri është e mundshme. Ai e mbjell kështu ritmin e qëndresës nëpër kohë dhe atëherë dhe atje tek edhe ai vetë do të ndihet i pafuqishëm përballë stuhive dhe kur në çast nuk sheh shtegdalje, përsëri e rrëmben shtizën donkishoteske, atë të fjalëve të vërteta poetike. I mbetur që në fëmijëri jetim, bashkë me asketizmin e fëmijërisë së vet ai do t'i hyjë betejës poetike që populli i tij të mos mbetet jetim në histori. Dhe ai është i vetëdijshëm, si edhe shumë shkrimtarë të tjerë të mëdhenj shqiptarë, se ata në histori janë në rolin: atje ku shteret shpresa e popullit ta rikthejnë, atje ku këputet kënga e popullit ta vazhdojnë atë, atje ku të tjerët kanë kaptuar përpara, t'i mbërrijnë ata, gjithnjë me një hov dhe hapa më të mëdhenj nga ç'janë mundësitë e tyre. Dhe, në këtë kontekst është fare i veçantë dhe specifik raporti i poetit Ali Podrimja karshi Kosovës. Është me rëndësi historike thirrja që Ali Podrimja ua drejton kosovarëve të vet në këtë rrafsh të gjërave.

*“Zgjobu, Kosovë!
Zgjobu nëna ime e dashur,
balli im, emri im i shkelur,
zgjobu. A po e ndjen
vajin tim”?*

Me rëndësi është që në këtë dyzëshmëri të vërvitjes së tij poetike dhe zërit të tjetrit, të popullit të vet, të të zgjedhurve mes tij, Ali Podrimja gjurmon dhe është në kërkim të akordeve

harmonike në kuadër të një polifonie, me çfarë ai vazhdon ta mbajë artin e vet poetik në majat e letërsisë shqiptare. Ai e lartëson në vete kullën e tij të brendshme, si simbol të qëndresës personale, që nuk është jashtë figurshmërisë kolektive për kullën e qëndresës. Përqendrimi për prestigj në universin e tij krijues mbetet optimal, absolut, kur thellohet shtresimeve arketipe të identitetit arbëresh, shenjëzuar nëpër kodet semantike të gjuhës së pazbuluar, të gjuhës së frymës dhe shpirtit kolektiv. Në ato momente para horizontit të poetit shfaqen dhe më pas hapen portat qiellore, para së cilave vjen me porosinë e gjetura kristalisht të qarta arbërore, mbërrin në botën të cilën e artikulojnë fjalët e vërteta poetike.

V.

Në kohën kur u botua poemthi lirik “Hija e Tokës”, i Ali Podrimjes shtatëmbëdhjetëvjeçar, ndaj fjalës krijuese kosovare, fjalës së shkruar poetike, ushtrohej një censurë e rreptë nga ana e pushtetit. Ishte kjo koha kur Jugosllavia (në kuadër të së cilës Kosova ishte krahinë autonome e Serbisë), në vitet gjashtëdhjetë, kur ajo çlirohej nga përqafimi i Stalinit dhe nga parimet krijuese zhdanoviste, ishte koha kur letërsitë e hapësirave jugosllave po çliroheshin nga kufijtë brenda të cilave nuk depërtonin përvojat dhe traditat e letërsive të Evropës Perëndimore, por njëkohësisht koha kur në Kosovë vazhdonte inercia e regjimit brutal, i regjimit të politikës antishqiptare serbe. Poezia në kushte të tilla ndiente nevojë të mbrohej dhe ta ruante qenien e vet edhe nga zhdanovizmi dhe realizmi socialist, njësoj siç ndiente nevojë ta mbronte edhe identitetin e vet dhe identitetin e popullit të cilit i takonte. Ali Podrimja pikërisht në këto kushte dhe rrethana mori mbi vete misionin madhor: *ta vërë nën mbrojtje poezinë dhe me poezinë, popullin e vet*. Dhe brenda këtij vizioni, Ali Podrimja ia arriti të realizohet më me sukses se çdo poet tjetër kosovar, kështu që në fillimin e poemthit të tij me titullin “Hija e Tokës”, së pari do të shënohen emrat e luftëtarëve nga Gjakova (qytet – simbol i

rezistencës kosovare), por edhe emra nga e kaluara më e afërt, si; Bajram Curri, Asim Vokshi, Ganimete Tërbeshi, Emin Duraku, Mustafa Bakia etj. Në këtë poemth, si një strukturë mikropoetike, Ali Podrimja thur dhe animon dimensione të këngë-zërit kolektiv të rezistencës, duke u shfaqur si një rapsod i dhembjes së popullit të vet. Ali Podrimja e ka të lindur ndjenjën e intensifikimit estetik të porosive vendimtare të cilat i ndien dhe i kërkon populli i tij. Në shprehjen e atëhershme poetike kosovare, Ali Podrimja do ta sjellë fuqishëm gjuhën e ekspresionit ezopik në letërsi. Dhe jo vetëm kaq, ai do t'i kalojë skemat e retorikës tradicionale poetike, huazimet mekanike nga krijimtaria popullore, të cilat i stilizon vërshimi i dogmës socrealiste në letërsinë e atëhershme. Përkundrazi, Ali Podrimja në poezinë e vet do të sjellë lojën shumështrësore të metaforës, të simbolit, të parabolës, duke hapur kështu mundësi të reja sidomos në rrafshin e lirikës patriotike. Ai do të jetë i ndërgjegjshëm që nga fillimet e veta për dhunën që ushtron censura, për rrezikun që qëndron mbi kokë si shpata e Demokleut, që përgjon dhe vigjilon çdo fjalë, në çdo kontekst metaforik. Kështu në këto rrethana frymëzimi, ai do të zbulojë motive plotësuese për të arritur besimin në fuqinë, në mundësitë donkishoteske të fjalës së vet poetike, duke vazhduar të kërkojë begatimin e saj polivalent. Në kushte të tilla të dhunës dhe kërcënimeve, poezia e Ali Podrimjes, si edhe ajo e gjeneratës së tij poetike (Azem Shkreli, Fahredin Gunga, Rrahman Dedaj etj.) do të arrijë majat e poezisë kosovare, përkatësisht të poezisë shqipe që përmes mjeteve artistike të zbulojë kodin e idealit kolektiv. Dhe nuk do të kalojë shumë kohë nga botimi i mesazheve me kod ezopik të Ali Podrimjes dhe gjeneratës së tij poetike, të cilët do ta sjellin deri në një gjendje përsosmërie komunikimin figurativ poetik me lexuesin, që tërë këtë gjuhë të tërthortë metaforike ta zbulojnë armata e lexuesve të rinj, sidomos nga radhët e studentëve. Dhe nuk mbahet mend që në këtë hapësirë poezia të ketë pasur ndonjëherë ndikim më të madh mbi ndërgjegjen e një populli të robëruar dhe të revoltuar, siç do

të jetë rasti me poezinë e Ali Podrimjes, me poezinë e gjeneratës poetike të tij.

VI.

Mund të thuhet lirisht se Ali Podrimja hyn në radhën e poetëve më të shquar të letërsisë më të re shqipe, sidomos të zhanrit poetik – lirikës patriotike. Poemthi “Hija e Tokës” do të jetë matricë e cikleve poetike që do të radhiten përmes emërtimeve *Guri, Kulla, Kënga e heshtjes, Kali i Trojës, Mali* etj.

Poetika e vargut të Ali Podrimjes, e çliruar nga konvencionalitetet tradicionale, është në shenjë të gjuhës dhe ekspresionit figurativ dhe në shenjë të një komunikimi të brendshëm dramatik. Fjala është për poetikën në kërkim të pandërprerë të mundësive të reja dhe origjinale drejt artikulimit të emocioneve, të imagjinatës dhe të filozofisë jetësore. Shtyllat paranojohëse të korpusit figurativ në poezinë e Ali Podrimjes, siç u përmend, janë *Guri, Kulla, Mali, Muri, Ura...* Poetika e Ali Podrimjes është e skalitur me dramatikën historike, nëpër stuhitë e së kaluarës dhe katarsisin e popullit, rrugë përmes së cilës artikullohet një unitet tërësor i ëndërimeve dhe i idealeve të individit dhe kolektivit, të ndërgjegjes individuale dhe kolektive. Në krahët e një simbolike të tillë antike dhe mitike të fisit arbëror, Ali Podrimja do të realizojë vlera universale në strukturimin artistik. Pikërisht përmes depërtimit të ëndërrimit të tij emocional, si dhe animimit të frymës dhe shpirtit të fisit, Ali Podrimja realizon vlera gjithënjëzore.

Cikli poetik “Pylli”, është një faqe e gjallë e udhëtimit poetik, me një hov donkishotesk nëpër universin e popullit të vet. Pylli, ky simbol i unitetit të botës dhe njerëzimit, është shkelur, është gërryer nga dhëmbi i ujkut. Përtej pyllit gjendet lumi, që e shuan etjen e tokës, etjen e të parëve, por që nëpër pyll të kalohet lirshëm dhe qetë duhet të të prijë *Ylli*, përkatësisht ideali, besimi i bartur në shpirtin popullor. I tërë cikli mbi *Pyllin*, paraqet një lloj mikrohistorie si një rrëfim i fuqishëm poetik nëpër të cilin ecet

përmes metaforizimeve alegorike, përmes simboleve të qëndrueshme dhe aluzioneve që shpalosin njëkohësisht porosinë e të parëve për të vërtetën e identitetit. Edhe poezia “Dëftore”, ndërlidhet me poemthin “Pylli” në rrafshin e së vërtetës së identitetit. Poeti Ali Podrimja edhe me këtë rast rrëfen përmes një narracioni të fuqishëm emotiv dhe impulsiv, për të njëjtën hordhi të pushtuesve të përbërë nga: perandorë, sulltanë, mbretër e carë që nuk prajtën së pushtuari tokën kosovare. Në porosinë që rrezatojnë nga kjo poezi ndërlidhet bindshëm “Kënga e heshtjes”, e cila është po kështu artistikisht njëra nga më të realizuarat e Ali Podrimjes. Që në fillim të vargjeve të poemthit ndihet “*pesha e heshtjes gjatë shekujve*”. Megjithatë, poeti me këtë rast do të zbulojë edhe një faqe të ndritshme në këtë histori të heshtjes: është heshtja që nuk është e shurdhër! Përkundrazi, ajo gjallërohet si dhembje, si plagë e gjallë që ëndërron dhe beson në shërimin e vet. Ajo pra nuk është heshtje përfundimtare, se mbi të është *Guri*, pastaj është ngritur *Kulla*, mandej *Pylli* – që të gjithë këto dëshmi që e kanë kohën e vet të palosur, të palosur të vërtetën e vet, dhembjen e vet. Heshtja kështu është syri i fjetur me fyellin në gojë, pranë këngës së zogjve. Dhe kështu mbillet edhe një variant metaforik për të sfiduar poetikisht kohën kolektive, vazhdimësinë ekzistenciale të qenies. Fjala është për dëshmi, për kërkim të pandërprerë të përsosjes së shprehjes poetike, dëshmi e fuqizimit të individualitetit poetik.

VII.

Shtyllë racionale e këtij sistemi imagjnativ është besimi i tij se dalja është e mundshme, përkatësisht besimi se liria mund të jetë e prekshme, nëse në çastin e duhur zbulohen dhe shqiptohen fjalët e vërteta të fisit, brenda një sistemi komplet dhe të qëndrueshëm, i cili deri në fund do ta mbajë të gjallë dhe vital tonusin e qëndresës.

Gjatë viteve kritike dhe tragjike të Kosovës, gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit XX, Ali Podrimja do të jetë ithtar dhe

bartës i një lirike me tension tematik dominues në poezinë e vet të asaj periudhe, në të cilën mbizotërojnë shumë qartë refleksët: refleksi i nxitur nga fushata shfarosëse e politikës kundër Kosovës dhe shqiptarëve, e ushtruar nga regjimi serb, ndërsa refleksi tjetër, nën ngasjen e hipokrizisë evropiane, përkatësisht të Evropës e cila ndaj fatit të shqiptarëve në momente kthesash historike ka qenë fatale. Në këtë kontekst nuk duhet përjashtuar edhe një refleks sado diskret që zë fill në sferat e errëta të vetë identitetit shqiptar. Hordhive pushtuese dhe terrorit të huaj, poeti do t'ua kundërvë kështjellën e vet të madhe si mburojë, simbolikisht të artikuluar si murim kështjelle, elemente që përbëjnë korpusin metaforik të kalasë shpirtërore me themel të thellë dhe rrënjë nga lashtësia antike arbërore. Edhe në këtë lirikë të lamentit dhe klithjes ditore, që synon mobilizimin dhe tërheqjen e vëmendjes drejt së kaluarës dhe fatit integral shqiptar, poeti Ali Podrimja për asnjë çast nuk do të bëjë kompromis me artin, ai i njeh shumë mirë stereotipat patriotikë për të mos qenë viktimë e lirë dhe për të mos rënë nën ndikimin e mobilizimit folklorik.

Dëshpërim dhe qortim të madh do t'i afishojë poeti Ali Podrimja “Evropës dyfytyrëshe”, kompromisit dhe heshtjes së saj ndaj zgjidhjes fatale historike për shqiptarët. Por Ali Podrimja është i vetëdijshëm gjithashtu se thirrja dhe klithja e poetit është brenda kufijve – duhet të jetë brenda kufijve. Thirrjet e tij për ta dëgjuar dhe mirëkuptuar fatin tragjik të njeriut kosovar pranohen në të gjitha qendrat evropiane, kudo që ai ka rastin t'i recitojë vargjet e veta. Kudo përjeton një pranim dhe solidaritet të paparë. Ndërkaq, Ali Podrimja, në diskursin e vet të rëndomtë poetik, nuk mund të jetë indiferent ndaj Kosovës dhe kosovarëve të vet, ndaj nacionalizmit të vet, gjest që i jep vlerë të posaçme krijimtarsisë së tij, përmes së cilës mbrohet dinjteti njerëzor.

VIII.

Ëndërrimtar i vërtetë është Ali Podrimja, poet që u mbetet besnik deri në fund iluzioneve të veta, universit të vet etik, që edhe nga disfata në disfatë, jeton pandërprerë me iluzionin e përtërirë. Vetëm ai është në gjendje ta njohë dhe ta ndiejë çmimin e madh të disfatës dhe të flijimit. Don Kishoti i madh poetik, në fakt, është sizif i lumtur dhe Promete këmbëngulës. Ai qëndron e mbijeton gjithnjë duke besuar se iluzioni i tij është i mundshëm, i vërtetë. Dhe kështu, pas këtij shkallëzimi imagjinar, në momente ai arrin të ngjitet deri në majat qiellore, gjithnjë i pasuruar me një iluzion të ri.

Të tilla janë dhe të tilla duken asociacionet e poetit tonë Ali Podrimja në raport me Kosovën e tij, në raport me atë enigmë të përjetshme poetike, me ars-poetikën e vet. Don Kishoti vihet kështu në kërkim të ars-poetikës së vet, në kërkim të botës së përsosur dhe harmonike, hendeqet dhe mullinjte e së cilës, “legjionet armiqësore” dëshiron t’i mposhtë me shigjetën e vet. Edhe Ali Podrimja si një Don Kishot i vërtetë mes kosovarëve, i cili shigjetë e ka penën, në librin e tij eseistik “Ëndrra kallëzohet në mëngjes”, në botim të Rilindjes, Prishtinë 2001, qëron hesapet me maskarenjtë e historisë më të re kosovare. Dhe atë që nuk ka arritur ta shprehë përmes diskursit poetik, në dialog me kosovarët e vet, Ali Podrimja përpiqet ta bëjë përmes diskursit të drejtpërdrejtë eseistik. Prandaj në këtë libër dhe në librat e ngjashëm me ese, që do të vazhdojë t’i shkruajë dhe t’i botojë thujtë në mënyrë paralele me vëllimet poetike, në radhë të parë zë vend realiteti aktual kosovar, sidomos ai i ngjarjeve tragjike gjatë dhjetëvjetëshit të fundit të shekullit XX, të cilat tërhoqën vëmendjen e opinionit botëror. Metafora është e qartë: ajo buron nga universi poetik në raport me qëndresën, në raport me realizimin e plotë të ëndrrës arbërore. Hapësira e ëndrrës është nata, nata e gjatë historike, nata e humbjes së dritës, e humbjes së lirisë. Pyetja e madhe ekzistenciale, të cilën e shtron Ali Podrimja në libër, është dilema: *Do ta meritojmë vallë realizimin e plotë të ëndrrës?*

I rrëmbyer nga vizionet donkishoteske, poeti depërton me shikim edhe atje ku të tjerët nuk mund të arrijnë: e sheh pjesën e ëndrrës të ëndërruar jo të plotë. Ndërsa ëndrra nuk është e djeshme, por është ëndërr *transhëkullore e arbit*. E kanë të shtresuar breza të njohur dhe të panjohur. Është po ajo ëndërr për plotësinë e së cilës sikur është i ndërgjegjshëm vetëm poeti i përzgjedhur. Ai, poeti, i vetëdijshëm për tërësinë e ëndrrës, do të jetë përherë dhe aktualisht në ankth përballë të panjohurës dhe të papriturës, i vetëdijshëm më në fund se mund të mos e meritojmë të ëndërruarën. Fjala është për një ëndërr të pazakontë – ëndërr shekullore. Këtë ëndërr dhe ëndërrim Ali Podrimja e vë në shërbim të vizionit të përbashkët: ëndrra rrëfëhet në fund të natës. Domethënë, në vizionin shqiptar ëndrra e ëndërruar vazhdon dhe ne jemi dëshmitarë, pjesëmarrës të realizimit të saj. Ndërkaq, kreatorin e vizionit në horizontin e pafund estetik, në përputhje me gjenin donkishotesk për ta hedhur shikimin edhe përtej horizontit të njerëzve, e pushton një shqetësim dhe ankth historik: a do të meritohet vallë ëndrra në plotësinë e vet? Të çliuar mbase nga të ligat dhe goditjet e të tjerëve, e të të huajve, si do të mund t'i përballojmë goditjet nga vetvetja, si do të mund të çlirohemi nga e keqja brenda nesh. Ai është i vetëdijshëm se liria universale fillon nga vetvetja dhe realizohet te të tjerët, vazhdon në vete vetëm atëherë kur është e vërtetë. Liria, do ta ketë të qartë Ali Podrimja, vuan nga patriotët e afishuar dhe ngasjet vëllavrasëse, nga gjakmarrja, nga kurthet e kurdisura të mediokriteteve, nga provincializmi dhe anarkia...

Poeti vërtet me të drejtë druan dhe është vazhdimisht i shqetësuar nga bartësit e ndarjeve, nga ndarjet e përkatësive partiake, nga karrieristët e obsesionuar, nga banditizmi dhe biznes-patriotizmi, nga korrupsioni, nga marifetet e pushtetit, nga indiferenca ndaj vlerave të vërteta. Dhe krejt atë që poeti Ali Podrimja nuk mbërrin ta demaskojë përmes vargut të drejtpërdrejtë si klithje dhe mesazh historik, arrin ta bëjë përmes diskursit të përditshëm me intonim narrativ. Përderisa me historinë dhe popullin komunikon me sukses nëpër kategoritë

kohë dhe hapësirë, duke e ruajtur superioritetin e strukturave të qëndrueshme estetike dhe etike si porosi ai në tekstet e veta eseistike do të pranojë të zbresë nga lartësitë poetike, për të treguar me gisht, për të emërtuar dhe për të ndëshkuar drejtpërdrejt, për t'i zënë me presh në dorë delikuentët.

...

Ali Podrimjen mund ta takoje si poet misionar aeroporteve evropiane, hapësirave kosovare, mes familjeve të armiqësuarra për shkak të gjakmarrjes. Do ta takoje si bredhte me melankolinë donkishoteske në shpirt, përherë i gatshëm që, pas çdo disfate njerëzore, të ishte i gatshëm ta vinte në shërbim fugën e tij të fuqishme poetike.

IX.

Që në kontaktin e parë me poezinë e Ali Podrimjes, përshtypja më e fuqishme që të përfshin dhe të mban është fryma, përmasa madhështore dhe dhimbës tragjike njëkohësisht që vibron dhe përhapet në hapësirë. Është një vizion madhështor i shtresuar ndër shekujt arbëror, si qëndresë dhe endërr, si shtyllë besimi, brengosës deri në dhimbje, edhe për pengimin e pandërprerë të rrugës, të objektivit që ka synuar ndër mote ta bëjë realitet. Është vibrim madhështor për arsye se pas vargbetëve dramatike, edhe të humburat ndër shekuj, besimi dhe ëndrra rish-tazi lindin nga e para, përherë si Feniks i përtërirë, brengosës dhe i shqetësuar, i pagjumë dhe shpresëdhënës... Është poezi që bart mbi vete misionin e luftëtarit drejt ëndrrës së shtresuar madhështore dhe dramatike, në kohën dhe hapësirën shqiptare; Ali Podrimja, përkatësisht është poet i paracaktuar që në lindje për të qënë zë përfaqësues i tërë këtij shtresimi të botës shqiptare gjatë historisë. Në thelb të kësaj poezie është një shpirt i brendshëm i akumuluar gjatë kohës, bashkë me shtresimin e ëndrrës kolektive. Kështu, ndjenja dhe kënaqësia estetike e së

madhërishtes dhe dhembja do të jenë thelbi shpirtëror dhe mendor i vizionit poetik të Podrimjes që do të vigjëlojë mbi të nesërmen personale dhe kolektive bashkë, e që në këtë poezi vjen zë lirik i natyrshëm. Është zë i artikuluar i tërë kësaj bote shqiptare, që u shtri jehonë në tërë hapësirën e etnisë. Brenda këtij artikulimi Ali Podrimja në poezinë e vet krijoi një poetikë personale, një regjistër të pasur shprehjesh figurative të papërsërishtme, shprehje me një dendësi kuptimi dhe emocioni të brendshëm dhe estetikë të përsosur. Krijoi një poetikë të artit të vet që diti të mbyllet përballë kontrollit ideologjik të kohës, por që diti të hapet përballë lexuesve të vet, sidomos përballë rinisë studentore të Kosovës, që në vitet shtatëdhjetë sidomos rritej, formohej, shtothej me të madhe, duke u mësuar të komunikojë me gjuhën ezopike të Ali Podrimjes.

Pikërisht në këto rrethana e filloi krijimtarinë poetike Ali Podrimja, në fund të viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar, përkatësisht në fillim të viteve gjashtëdhjetë, së bashku me brezin poetik më të talentuar të mbarë poezisë shqipe gjatë gjysmës së dytë të shekullit njëzet, me Azem Shkrelin, Rrahman Dedajn, Fahredin Gungën dhe Adem Gajtanin.

X.

Një popull që lind poetë si Ali Podrimja, poetë përmasash universale, është popull i bekuar. Për gjysmë shekulli, ne, shqiptarët, u mësuar ta ndiejmë poezinë e Aliut si një bashkë-ëndërrim, si një bashkëmendim, si një zë thellësisht tronditës, të mprehtë, të qëndrueshëm, bartës të dhembjes së të gjithëve, si një melodi të përsosur që gjithnjë është aty kur na duhet dhe na shoqëron pa e kërkuar. Të mëdhenjtë si Ali Podrimja, që e arrijnë këtë prani të natyrshme, të vetvetishme, në jetën e një kombi, kur ndahen nga ne, nga kjo botë, humbja përjetohet si gjëmë, si një terr, si zbrazëti e pangushëllueshme. I tillë, goditës na erdh lajmi i kobshëm për Aliun.

Tërë vepra letrare e Ali Podrimjes ka qenë Kosovë dhe me Kosovën: “ëndërr dhe zhgëndërr, dhembje e madhe dhe etje e pashuar”. Edhe kryevepra e tij dhe e poezisë shqipe, *Lum Lumi*, edhe fati i Lum Podrimjes është një dhe i pandarë me fatin e Kosovës. E tillë u ngjiz bërthama poetike e tij që nga hapat e parë, që kur solli në jetë këngë të frymëzuara për Kosovën, ciklin e poezive “Gjaku im që nuk falet”, dhe poemthin “Hija e tokës” që, me gjuhën moderne poetike, të shkarkuar nga çdo nuancë patosi, artikuloi maja të pakalueshme në poezinë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit njëzet.

Kosova në poezinë e Ali Podrimjes është metaforë për Arbërinë, për ‘shumë Shqipëritë’, që do të jetë vizioni më i dhimbshëm dhe do t’i silltë rrotull poetit si ankth e shpresë, si ëndrra që thotë “më kërkoni në zhgëndërr”. Arti poetik i Ali Podrimjes është një shpirt i shqetësuar, një mendje në kërkim të përhershëm të lirisë, në kërkim të Kosovës ‘të pesë Shqipërive’. Në këtë kërkim dramatik ka bredhur me vargjet e veta edhe nëpër botë, është frymëzuar nga vlerat e saj, dhe Europa e kulturës e ka mirëpritur dhe mirëkuptuar poezinë e tij si të asnjë poeti tjetër shqiptar.

Paraqitja meteorike dhe fillimet e Ali Podrimjes në moshë fare të re me talent të jashtëzakonshëm, me një mendim të lirë dhe ligjërim ironik, të shkarkuar nga çdo skemë, ishte befasi për një kohë dhe mjedis ideologjikisht të ngarkuar dhe me jetë të ndrydhur kulturore, por njëkohësisht ishte edhe ringjallje dhe vazhdimësi e frymës deradiane dhe naimiane, që e kishte artikulluar vizionin për Shqipërinë eterne, për përjetësinë e qenies kombëtare.

Poetët e këtillë, që besojnë dhe kanë ndjenjën se janë të paracaktuar t’i thonë metaforat e vërteta dhe ta zbulojnë të vërtetën e njerëzimit, ecin më shpejt se historia, e transcendojnë realitetin dhe kalojnë superiorë në bregun e asaj ane. Poetët e këtillë i ngelin besnik deri në fund universit të vet etik dhe jetojnë pandërprerë me iluzionin e përtërirë, edhe atëherë kur janë në gjendje ta njohin dhe ta ndjejnë çmimin e madh të disfatës dhe të

flijimit. “Na pate apo të kishim-“, ia shtron pyetjen hamletiane Aliu Kosovës.

I duhej dhe i duhet botës ky zë, tokësor dhe qiellor, ky zë lirie, për të sfiduar një nënqiell robërie. I duhet njerëzimit kjo këngë tronditëse, e të vërtetave të mëdha, këngë thellësisht njerëzore, e njeriut të paepur në betejat e pasosura të jetës. Këtë rrugë të përjetshme, duke sfiduar të keqen dhe për fisnikërimin e botës shqiptare dhe njerëzore do ta vazhdojë fjala jetëdhënëse e Aliut tonë të madh, me të cilën do të frymëzohen brez pas brezi shqiptarët.

Ali ALIU

THIRRJE

Jeta e re, Prishtinë, 1961

THIRRJE

THIRRJE

Pllumbi im, kush të dërgoi,
Pllumbi im
– Krahlehtë me at fjalë?

Ti je mâ i miri pllumb,
Pllumbi im
– Mâ i shpejti në kët dhél!

Prej kah në fushë t'ballit tim,
Pllumbi im
– Kah po fluturon?

Ti je mâ i bukuri pllumb,
Pllumbi im
– Krahthyem për at fjalë!

Medet, po më kallen syt,
Pllumbi im
– Lilin me çka do ta shof?

Kush do t'ia dërgojë letrën time t'mbrame,
Pllumbi im
– I piklluem?

II

Shiqoj njerëzit tue vërshue
Shtigjeve të jetës –
Kurrkund fytyra jote.

N'prag i pres dallëndyshet
Që pranverën e thërrasin –
Kurrkund krahu yt.

Dielli në ballin tim
M'i ngroh kaçurrelat –
Kurrkund rrezja jote.

Ndëgjoj kangën e zogut
Që përshëndet lindjen e agimit –
Kurrkund zani yt.

Lili,
Livadh i kositun i harrimit!

III

Trenisht nisa me bërtitë në vedi,
Por ti askund s'm'u përgjegje.

U dogje n'larsina e caqe të jetës
Bukë e krypë n'grushta t'vocrrakut shtrëngue

E lejleku i shtëpis sonë qiellin e ka çpue
Dhe krahët i janë përgjakë tue të kërkuë.

Por ti kurrkund nuk je, s'po të shof, o vlla!
Medet, n'bregoren tonë po digjet blerimi.

IV

Natë. Qyteti im po flet.
Rrugët po ecin mbas meje. Unë qe sa kohë po t'thërras,
Po bredhi – po ti ku je, o Lil?
As qeni i shtëpis sime s'po leh,
As pijaneci plak s'po shan mâ rugëve.
Thue, të gjithë njerzit janë shndërrue në mue
– N'andrra dhe në dëshira.

*

Androva vedin. Kalli dola me shetitë.
E ti – sa afër më je: me duert e zgjatuna, sa ambël më thërret
Në jetë – me ata sy të madhej, me at zemër zog!
Sa larg m'je prej kësaj nate të kallun qysh në nisjen time!

*

Ky âsht qyteti ynë
Në prralla dite që e mësuem si kangën, si lutjen për jetë.

Ky asht, si thonë, zgjidhja me shum vetë
Ku secili e gjen vedin.
Këtu për secilin rruga e fatit vizohet drejt lindjes mâ të re,

Që kurr nuk të kthen te vdekja e parë.
Ky është qyteti im
– Kanga e secilit.

*

Ti je ai që natë për natë n'ballin tim fluturon
Dhe m'ikë si andrra e shkurtë në të gëdhimë t'agimit.
Ti je ai që natë për natë m'len me buzë të kalluna
E më tret, më tret në kujtime.
Ti je ai që m'bân me jetue
- Për të nesërmen e harrimit!

*

... Sonte kurr s'kisha me të thirrë
Sikur mos të vujsha për ty,
– Kurr, Lili!

Larg po krisin qeshjet e agimit.
Qyteti im po zgjohet dhe qeni i shtëpis sime po leh.
... Haj, kujt me ia këndue kangën e andrrës së mbramë,
Kujt me ia hapë zemrën mâ shumë se ty, ma shumë se vedit,
Kend m'e quejtë me emnin tand mbas sa vjetësh
– Lili, nëse kurr nuk kthehesh?

V

Më ka marrë malli
Me t'pa tue qeshë –
Me ndëgjue kangën e gjakut tand pa va,
Si kangën e qiellit kur nis me reshë;
Me t'pa tue luejtë me guraleca,
N'valë t'Erenikut tue u la...
Më ka marrë malli, o vlla,
Me t'i puthë mollzat e faqeve
Dhe syt e shkruem...

Nana tash â plakë...
Nën hijen e mollës, si përherë,
Çarapë thurë e vek punon
Dhe or'e ças shiqon n'derë –
Thuese dikend e pret.

VI

Zgjatmi duert e vogla,
Zgjatmi edhe pak t'i puthi –
Zgjatmi, o shpresa ime!

Hapat tu më troklojnë ende te porta.
Rrafshit të Dukagjinit
Ndëgjoj ende zanin tand tue udhtue...

Zgjatmi duert e vogla,
Zgjatmi edhe pak t'i puthi –
Zgjatmi, o drita ime!

Nana, tash, sa herë më shiqon –
Në mue zgjohen dhimbjet –
Malli m'rigon, o vlla.

VII

Si blerimin – Çabratë e ndjeu vdekjen tande

At natë –

Thellë si blerimin.

Në brrylat e lisave zogjtë krahët i thyen n'fluturim

At natë

– O, trup i kallun nën qiellin e dashtun të Dukagjinit!

VIII

... Lili,
Zgjatmi duert e vogla
Zgjatmi edhe njiherë t'i puth!

O, sikur njimijë vjet jetë t'i kisha
Pash e m'pash dheut kisha me i ra –
Të vetmen etje me e shue, o vlla...

Zgjatmi duert e vogla,
Zgjatmi vetëm edhe njiherë t'i puthi,
Lili!

MOS MË HARRO

*Ferid Grezdës, gjimnazistit,
që fashistët e mbytën mizorisht
me 2 prill 1943 në Gjakovë.*

... Thue të gjithë njerzit kanë vdekë,
Të gjitha konaqet janë mbyllë
E bjeshkët shembë;

Thue mortaja ka ra:

Asnji njeri gjallë s'po ndihet,
Asnji kalimtar i vonuam s'po luen –
Thuese ka vdekë Metohija jonë...

I

Në syt e mij jeta dhe vdekja janë palue.
Në syt e mij votrën e gëzimit e kam kallë.
Në syt e mij flaka dhe etja po rritet –
ajo fjalë.

Po! Edhe në ballin tim
Dielli i gjakut po lind –
Dielli ynë ...

II

Natë. Unë përsëri po shof.
Unë përsëri po ju njof – njerëz, shokë, vllazën!
Përsëri po kënaqem me ju si me Metohin. Po rritem.
Pse heshtni, pra? Ku jeni? A po më ndieni?
Pse s'ia falni edhe ju – si unë, si na –
Në këtë natë prilli ballin dhe emnin Metohis?
Pse s'ma thueni at fjalë që sa kohë rritë e keni...

O, putheni heshtjen, pashni moshat tona,
Që na i përbiu nata; putheni,
Le të kallet flakë
Prej puthjeve tona,
Edhe kjo natë e ftoftë prilli!

... Qetsi.
Vdekje edhe n'fjalë.
Vdekje edhe n'ecje.
Vdekje edhe n'mue.
Unë i di prallat tueja.
Unë i di dëshirat tueja.

Unë ju njof, ju njof si vedin!
Pse heshtni, pra? Ku jeni? A po me ndëgjoni,
Apo të gjithëve toka sonte u ka lëshue?!

– O, unë përsëri po shof.
Unë përsëri po ju njof – njerëz, shokë, vllazën!
Përsëri po knaqen me ju,
Po rritem.

III

Nanë, mbaju,
Pikë loti mos derdh për mue!...

(– Vlla,
Ma afro ballin e ftoftë,
Të përgjakun,
Ta puthi edhe një herë
Në këtë natë t'plumbët prilli!)

IV

Qyteti im dhe hapat e mij t'kalamendun.
Qyteti im dhe Metohija.
Qyteti im dhe unë.

Bri prronit të përgjakun
Plepat kanë ra –
Janë zhytë n'ujë:
Thue, ujë po duen me pi,
Thue, etjen po duen me shue,
Thue, po vdes edhe i mbrami njeri!

E unë –
Përshëndetjen e mbrame
Te pragu i shtëpis s'djegun e kam lanë.

V

Liri,
Vetëm ti i ke syt
Mâ të zjarrtë se të diellit;
Vetëm ti
Zemrat na i ke dashunue thellë,
E gjakun në dej
Na ke kallë!
Jemi rritë
Me flakën tande në gjij...

– Në gjak.
Në frymëmarrje.
Në mendime,
Po të ndiej – Liri,
Fjala ime e parë dhe e mbrame –
Fjala jonë e zjarrtë!

VI

(Kujt po i çilet ky vorr?
Ky zjarr?
Kend paskan bâ kurban, medet?!

Heshtje. Asnji përshpëritje,
Asnji fjalë...)

Në mue
Flaka dhe etja
Po rritet – ajo fjalë.

– Shok,
Mos m'harro
Kurr!...

(O, unë
Kurr s'kam me të hjekë
Prej zemre –
Prore kam me u rritë
Me ty,
Me ju!)

VII

Të gjithë zogit kanë fluturue
Prej ballit tim,
Në syt e mij dita ka harrue
Me çelë
Dhe nata
Me ikë.

Çka po bajnë me mue?
Vallë, ku po më çojnë?

Qe sa kohë vdekjen me sy po e shof.
Qe sa kohë
Përshëndetjen e mbrame
Te pragu i shtëpis e lash.

Çka po bajnë me mue?
Vallë, ku po më çojnë?

Mbi ballin tim të përgjakun
Qielli më ka ra dhe ylli im.
Medet, kush do t'i tregojë nanës
Për vdekjen time mizore?

*

Sa herë pranvera lulon –
Nana me brezin e ri
Feridin e zemrës kujton.

METOHIS

(UNË I PARI)

U bana dashuni
Me rritë buzëqeshjen e madhe.

Ti je bukuri –
As dielli
As hano s't'ka!

U bana dashuni
Me u rritë në ty, Metohi.

(MALLI)

Metohi – gjumi im i parë,
Qetsi e dëshirueme.

Pash e m'pash mundohem me të ra
N'grykë t'shkambit me pi ujë bore,
N'pishnaje t'malit me u ba syni yt.

Metohi – etje e pashueshme e fëminis sime;
Metohi –
Qetsi e dëshirueme.

(BETIMI)

Po betohem në dritat e syve të mij,
Se ti je –
Dashuni.

As nana,
As grueja mâ e dashtun
S'e ka shiqimin tand të nxehtë.

Po betohem në dritat e syve të mij,
Se ti je –
Dashuni.

Edhe kur dimni të ngrinë,
Edhe kur pranvera të veshë
N'hijeshi.

(EDHE...)

Edhe i mbrami plep
Nëse ka me t'u rrxue –
Unë do të due.

Edhe e mbramja votër
Nëse ka me t'u shue –
Unë do të due.

Edhe i mbrami burrë
Nëse ka me të mbetë në fushë t'mejdanit –
Unë do të due...

(SA HERË)

Sa herë kam vdekë
Në buzët tua
Prej mallit...

Sa herë kam fluturue
– Flutura e përgjakun,
Me flamujt e mjerimit...

Sa herë me syt e mij,
Të kaltërt,
Janë ndezë vravashkat e pikllimit.

(ME U DASHUNUE NË TY)

Bukuri është me u dashunue
N'dashunin tande.

Bukuri është me u dashunue
Në rrugën tande.

Sa shpejt po rritet
Lumi dhe bari kujtimeve.

(DUE TË JEMË)

Nganjisherë due të jemë lum,
Të rrjedhi nëpër damarët e tu.

Nganjisherë due të jemë diçka e ytja,
Bota yte të pushojë në mue.

Nganjisherë due të jemë ti,
Heshtjet dhe shinat e moteve t'i ndij.

Nganjisherë due të jemë etje,
O, deri në pikë me t'i pi ujnat tu, dashuni –

Metohi, zjarr i ndezun në mue!

(NATA)

E lehtë dhe e butë,
Si hapi im –
Asht nata në ty.

E dashtun dhe e vrullshme,
Si krahnori i grues –
Asht nata në ty.

E qetë dhe e freskët,
Si shiqimi i vajzës s'dashunueme –
Asht nata në ty.

Metohi – vendlindje e artë.

(LINDJA E MADHE)

Qe synin e djathtë me m'pa
Kronin e shpirtit etjen me shue
Dhe dorën flamurin nalt me e mbajtë.

Qe diellin që ngamë
Në báll me ta vu
Dhe pranverën e gjakut tanë.

Qe konaqet krenare
Që koha e re t'i pruni
Dhe shtyllën e dritës.

(MADHSHTIJA)

Buka, krypa dhe zemra
– Konaku i gjithkujt
Dhe fjala e ambël.

Buzëqeshja e fëmis
Në fytyrën time
Dhe të mikut t'ftuem.

Vasha besnike dhe nana
Që presin e luejnë me djalë
Te konaku i ri.

Bukuri e vendlindjes sime
Që s'ta kap syni as mendja –
Madhshtija

MAGJUPJA

MAGJUPJA

Në bebza i palova rremat e moteve –
Po kangën kurr s'e sosa:
As në darsma,
As në lodrat e mija të dalldisuna...

Defi – ngushëllim i shpirtit,
Defi – vaj i thekshëm i shpirtit...
E çamparet – gjethet e rinis sime
Të dridhuna n'sqenën e përditëshme
Dhe n'grishjen e jaranit...

A ka kangë mâ të bukur se kanga ime?
A ka kangë ma të dhimbëshme se kanga ime
E pasosun:
Prej muzgjeve n'agime,
Prej lotëve në qeshje...

Vetëm kanga ime,
Vetëm kanga ime!

*

Sepetat – ditët e mija t’thuruna,
Sepetat – ditët e mija t’gëzueme,
Sepetat – ditët e mija t’sosuna...
E pikllimi – loj’ e rëndomtë e qenjes sime.
Kasollja e baltueme e thjeshtë, si unë, plot halle –
Kasollja e baltueme prehje e trupit t’shkallmuem
Gjatë ditës së randë,
Dhe vdekje e dëshirave t’rrokuna dit’e natë
Me fatin tim.

Kurrkush prej nesh vuetjtet njani tjetrit s’ia dijmë
(Se vuetjta âsht lamsh i tjerrun
N’boshtet e zemrave tona) –
E unë jam vuetjje e pakëndueme
Në ditët e përbime
Me – ngërçat e idhtë t’kangës piklluese
– E dejun me vaj’ e qeshje t’mija.

Unë jam gruaja mâ e bukur dhe mâ e keqe
E qytetit tim.
Unë jam e çnjerzuese –
Rinin ua fala rrugëve t'unta
N'dalldisjen time,
Kur thimthat e gjinjve i shkurtova për jarana...

Unë jam dashnorja e gjithkujt.

II

Kam këndue, prej agimit n'agim, në shtëpin e panjoftun
Shejtani im.
Prej agimit n'agim...

– Kalle, Magjupe, pash besën, kalle!

Shtatë mahallë kanë pi kafën e zezë të syve t'mij filxhan,
Shtatë mahallë janë dejë me gurgullimat e gazit dhe vajit tim!

Mbas darke, gjû më gjû, kam këndue
N'odë të burrave, me burra –
Shejtani im,
Gjû më gjû...

Dhe, vaj, kanë qeshë me vajin tim
Prej agimit n'agim!

III

Trenisht dhe mâ bukur këndova kangën tande,
voglushi im,
Që të rrita si pllumb ndër ahengje e konaqe –
Plot kangë e darsmorë.

Jetë dhe vdekje,
Dashni dhe urrejtje lidha me fije shpresash kudo
N'ballin tand – prehje e dëshirave dhe e dhimbjeve të mija.

Njiqind çika t'mahallës i mblodha n'darsëm, voglushi im –
Haj, njiqind çika të shkelën...
Dashi me brina qiellin deshti me e çpue si zemrën tande!

Haj, qerpikët tu – dallëndyshe të dejuna:
Haj, faqet tua kuq si gjaku – dallëndyshe të trenueme;
Haj, rinija jote lis me rrema – dallëndyshe t'hutueme...

– Haj, ndër njiqind çika të mahallës nusen ta zgjodha!
Kur të vijnë krushqit, kur të vijnë, voglushi im –
Do ta kalli edhe çerdhen e dashnis
Në lule të ballit!

IV

Gjithkund të kërkova edhe në n'harrim,
Dashnija ime e vogël,
Gjithkund.

Beqarët trenisht po m'shkelin:
– Magjupe! Magjupe!
Po kërsasin qeshjet.

Hej, zemrën po ma shkyejnë si qejt.
– Magjupe! Magjupe!...

Qe i vetmi gëzim,
Që m'dêhe;
I vetmi diell
Që m'nxeve –
Dashnija ime e vogël.

V

Na përbinë. Haj, në shtatë mahallë na përbinë
Dashnija ime e vogël – na përbinë
N'shtatë mahallë.

Treqind krushq nën hijet e ballit tim pinë.
Haj, treqind krushq ladruen nëpër ballin tim.

Do ta shkelsha edhe vedin; do të digjesh nga'i grimë
Në prushin e carrokëve
Sikur balli yt mos t'i shembte si bjeshka,
Dashnija ime e vogël –
Sikur zjarmfiksati mos t'bahshin poterë
Mbas hijeve t'mija t'djeguna
– Mbas krushqëve.

O, treqind krushq nën hijet e ballit tim pinë.
Treqind krushq ladruen nëpër ballin tim pa kufi.

VI

Thirri pentaret
T'ujiten fushat e shpirtit t'thamë
Dhe balli yt të flladitet
Me zemrën time!
Thirri, mos shuhen syt e zez – kokrra rrushi –
Dhe ditët.

Haj, n'ballin tand carrokët po luejnë me yj –
Po ma pijnë gazin si në sarajet e begut!
Haj, dashnija ime e vogël,
Ma vrave zemrën me shigjeta – si t'moçmit...

Ktheu edhe kur të plakesh –
Edhe kur të plakem do të jemi të rij!
Ktheu, dashnija ime e vogël,
N'krojet e trupit tim t'gazit e t'lotit –
T'i rrisim carrokët me buk' e krypë,
Me diell e zemër dashnije...
Ktheu, dashnija ime e vogël, pashë syt –
Kangë e haré deri n'qiell t'i kallim!

Ktheu – se edhe kur të plakesh,
Edhe kur të plakem do të jemi të rij.

VII

Krejt venën e hardhis sime ma pive,
Shejtani im,
Krejt – bora ime e parë n'flokët e mijj...

Tanë jetën ma shkele, rrema lulesh tue thye,
Shejtani im,
Pa fije gazi e mëshire n'sy.

Tanë jetën më rroke të dejun,
Shejtani im –
Miku dhe anmiku im!

ILIRIANA

(STUHIJA)

Oxhaku i shtëpis sime fluturoi.
Haj, kali im i bardhë, kah m'ike –
Ilirianë, a do të mbërrijë në konakun tand?

Ujku i zi tanë sy e vesh, i çartun,
Po uluron ahishtes së ftoftë,
Çdo derë ka mbyllë, në çdo konak ka hy.

Unë ku me i mëshefë duert e syt e mij
Haj, si me i shpëtue ato çerdhe të bardha dielli –
Kali im i dashtun, kah m'je?...

Sonte vonë do t'më çilet dera e konakut,
Vonë do të vdesi kjo stuhi n'bredhje –
Iliriana ime, a kam me të pà mâ?

(KURR AT EMËN)

Si të kanë quejtë para vdekjes, kurr nuk ke me dijtë.
Binarëve t'jetës, tue rrëshqitë, s'kemi me u matë
për emnin tonë

Me hijet e mesditës.

Qysh tash jam njeri i përshëndetjeve,
Njeri i zgjuem prej gëzimit,
E ti – shpuzë jete për at emën.

Kurr nuk ke me dijtë si t'kanë quejtë para vdekjes,
O, dëshirë e flakët, që aq shumë deshte me qenë e huej –
Kurr at emën!

(KJO NATË)

Sonte si vedin të kujtova, Iliriane.

Nesër mbas pllumbin tim do ta ndjeki deri te ti.

Sa randë po gërhet kjo natë e kujtimeve të zgjuemel!

(ILIRIANA)

Të kam pasë thanë një ditë:
Të gjitha rrugët e jetës të ti do të më çojnë;
Të gjitha kullat e heshtjes
Rreth vedi do t'i ngreh – për at fjalë.

Të kam pasë thanë një ditë:
Edhe një hap më larg me ty do ta bëmë
O thirrje e parë dhe e mbramë
Që sot ia mbërrinë në konakun tim.

(KURR, O ILIRIANE)

Vetëm kam dalë. Caqet e largsit e jetës flakandë janë
Si syt e mij, si thirrjet e mija. Në vedi gjithçka po numroj.
Po shaj si rëndomë. Posht'e nalt, si i çmendun, po endem

– Por ti ku je, o Iliriane?

Pllumbat janë zogjt më të lumtun. Jeta për ta s'ka kufi.
Njerzit dashunohen në ta, mashtrohen dhe janë krenarë
Edhe pse dikush i quen: pllumbaxhij,

– Por ty si me të quejtë, o Iliriane?

M'âsht tekë emni si vdekja. Jasht zemrës kurrqysh
S'po mundem me të nxjerrë, beso-kurrqysh! Çabratit tatpjetë,
Shungullon ritmi i jetës, ritmi i kangës që m'thërret.
Posht Ereniku rrjedh e nget i kthjellët
Nëpër dejt e Dukagjinit, si fëmija i lazdruem,

– Por ti ku je, o Iliriane?

Gjanë e gjatë jam shtri në livadhin e jetës. Pllumbat...
Pse edhe njerzit nuk janë pllumba?
Pse edhe na s'i kemi krahët dhe dashunit e tyne,
e dashtun, pse?...

– Hej, sikur të muejsa dyshimin me ta hjekë
Kurr nuk të kisha thirrë e dashtë kaq shumë...
Nga pak çdo ditë, o Iliriane – kurr!

(DITA E VONUEME)

Kurr ajo ditë, kurr ajo natë e dashtun, në jetën time,
Kurr ajo kangë, ai zog dielli,
Ai gëzim, si n'at ditë marsi fatlum
– Kurr, Iliriane!

Pranvera sa herë lulon në kopshtin tim
Gjithkah prillin e kuq, dal e shkeli dathë;
Gjithkah matem me ty, shpirti im, si fëmija me hije,
Gjithkah e ndjelli at zog dashnije...

– Haj, kurr ajo ditë,
Ajo natë e vetmueme kurr
– Në jetën time!

(AT DITË)

Valë-valë zdirgjet Ereniku rrafshit të Metohis
Si krushku me kangë,
E mue ma kanda ta sodis gjithmonë kët mrekulli.

Ti po lahesh bregut tij, po nget zbathun si fëmijë
Me gëzim në sy, me trupin e mbështjellun në pelerinën
e bardhë,

Me flokët e shprishuna si era
– Te ura, derisa të kalojë kjo rê me shi
E dielli prap të dalë, te ural...
Qetas hapat po i qet. Fshatari po e ngul shatin
Deri në gjû lavrën dhe farën po e qet;
Bariu në kupë të qiellit kangës po ia thot.
E ti, ti po kotesh, po rritesh
Në djepin e dashtun të Metohis, që po zgjohet
me diellin e vet.

Valë-valë zdirgjet Ereniku në rrafshinë,
Si gjithmonë gjarpron, ec e gurgullon. Dhe – sa çudi:
Njerzit trupojnë, freskohen me ujin e tij
Pa dajtë se diçka kujtim i lanë kur të shkojnë!

E ti po m'matë ende – motet po i përcjell në vijim
– Arat e reja kah po lavrohen,
Ti, që syt i ngjyve në syt e Metohis sime
At ditë, kur të thash: – Të due, e dashtun,
Por nuk diç kend më shumë, ty apo Metohin!

(LAMTUMIRË, ILIRIANE)

I kam mbyllë syt si i vdekuni.
Nëpër livadhin tim të gjelbërt
S'po mundem me e pa largimin tand.

Heshtni! Nji minutë, ju lutem,
Për vdekjen time të vogël.
Heshtni, zogjt e mij të bardhë.

Tanë bota sharrue ka në mue.
Ti ku je? Në cilin saraj je strehue?
Jasht meje, qebesa, asgja s'ka shpëtue.

Shelgjet vajtuese të pikllimit
Po rriten drejt qiellit –
Sa e zjarrtë paska qenë dashunija.

Medet, sa vështirë qenka
Me ta thanë at fjalë të mbrame
– Dashunija ime e madhe.

(DËSHIRA)

Zotin e kam urrejtë kur s'kam mujtë me t' dashtë si n'andërr,
Zotin e kam urrejtë kur kam vjedhë në rrjedhjen time
– Rrugëve kur kam luejtë, me lotë ndër sy; kur kam nga si vocrrak
Mbas maqinave dhe qerreve, si mbas xixillojave e fluturave.
Zotin e kam urrejtë kur kund s'kam mujtë me të gjetë, si n'andërr
– Por ty, kurr jo, kurr!

Zotin e kam sha në njimijë gjuhna t'endacakëve,
Kur nuk ke ardhë me ditët e mbarsueme, me ditët që ikën
Me lojnat e fëminis sime të nxehtë
– Por ty, kurr jo, kurr!

Zotin e kam urrejtë kur s'kam mujtë me të dashtë,
Kur s'kam pasë fuqi me të krijue mâ bukur se n'andërr
– Ty, që m'plake në pritjet e mija të gjata!

THIRRJE

Botim i autorit, 1973

*Ferid Grezdës, Remzi Pulës, Shani Nushit,
Ferhat Binishit dhe të rinjve të tjerë që
ranë në LNÇ të jetojë ky popull*

autori

PËRMENDORJA

UNË

Gjersa s'dija të këndoj
vera bënte vetëvrasje në mua

gryksi farkonte thika vdekje
toka ime lindte plepa të rinj

gryksi ndizte zjarre kobi
toka ime brofte në këmbë

Gjersa s'dija të këndoj
në tokën time binte shi

veten kërkoja nëpër botë

tani kënga s'më le të qetë
kryet do t'ma hajë një ditë

KULLA

Për shkak të dashurisë për shkak të urrejtjes
babai im ka ngritur një kullë
Në maje të botës e ka ngritur
deri në tokë e kanë rrënuar zotrat
Motra ime vëllai im kurban është bërë
babai im atëherë perëndi ka sharë
gurin e rëndë në themel e ka vënë
në shtatë konaqe muratorë ka kërkuar
Sa më lart kullën që ka ngritur
aq më të fortë veten e ka ndjerë
Një ditë babai im është mbyllur
në qiell i dashuruar në tokë i harruar
e kanë kaluar helenët e romakët
e kanë kaluar mbretit e sulltanët
e kanë kaluar ushtritë e gjeneralët
e babi im s'ka besuar në fuqinë e gjakut
në fuqinë e fjalës së shpirtit
Nuk di prej nga mjegull ka qenë
do njerëz kanë ardhur në të bardhë
pas njëmijë vitesh para një milion vitesh
Prej lashtësisë thonë se kanë ardhur
nëpër mure të pëlcitura të kullës kanë hyrë
gur e m'gur atje lart janë ngjitur

në majë të botës kanë mbetur sot e atë ditë
E babai im atëherë gurin e rëndë
në themel ka vënë gurin e përrallave
në takim me zotin e djallin ka dalë
ai këmbësor kohësh të mallkuara
E një kullë është ngritur njëmijë vite
mbi një asht mbi një emër ajo flet
për shkak të dashurisë për shkak të urrejtjes

PËRMENDORJA E NJË PRINDI

Më pyetni babai im ku e la sharrën e stërlashtë
më pyetni babai pse i ngjau detit të pa va
unë po ju fal nga një buzëqeshje të qelibartë
unë ngrah ballin kah sheshi i qytetit të bardhë
ku babai im jeton i gjallë në mermerin e historisë
ku babën tim e duan të gjithë pa hile e rrenë
e mëngjes për mëngjes e nderojnë i madh e i vogël
Më pyetni e unë ju them gjithçka për babën tim hero
për babën tim këmbonare kohësh që pushkë ka qitur
për mik në prak të shtëpisë kur i ka shkelur në besë
e ju i zgjatni duart u flitni fëmijëve deri vonë
për njeriun që kurrë nuk ka vdekur në gjunj
e që unë e njoh vetëm në këngët e kreshnikëve në zë
Më pyetni babai im ku e la sharrën e stërlashtë
më pyetni babai im pse i ngjau detit të pa va
e unë ju kërkoj vetëm ndjesë për babën tim
si për njeri si për njeri si për njeri

ÇKA MUND TË THEM TJETËR PËR BABËN TIM

Ju thashë babai im e ka pasur vëlla edhe ujkun e malit
e ka pasur vëlla edhe detin e harlisur Ju thashë
me grushta thatë e shpirt të trazuar luftuar ka si lua
me dhunë kur kanë shkelur në prag sapo na kanë vrarë
në megjë are Ju thashë babai im ka besuar e s'ka besuar në zotë
Kohën e ka matur me vdekje kohën e ka matur me lindje
në Bjeshkë të Nemuna sapo kanë dalë gjahtarët e marrë Ju thashë
gjithmonë ka ecur kah drita kah një diell i ngujuar në fjalë
një mot është verbuar duke u ngjitur një briri
se babai im shpesh ka dëshiruar t'i ngjajë zogut në hava
ai shpesh folur ka për dashurinë për tradhtinë e mikut
babai im me shumë emra babai im udhëtar motesh Ju thashë
E ju përsëri më pyetni për të E çka mund të them tjetër
se babai im ka pasur shumë ëndrra për jetën
se në grushta ka mbyllur blerimin sapo ka shkelur
rrugët e paskajshme të kurbetit sapo erërat e kanë lënë
dru të zhveshur në skaj të botës çka mund të them tjetër
se babai im ka pasur sy të mjegulluar Të gjitha fushat
e malet kanë bleruar në sytë e tij plot lutje e lamtumira
se babai im nuk e ka ndjerë vdekjen e vjeshtës

në majën e gishtave të verdhë as blerimin në jetë O ajo stinë
në duar të çara të babës sim që ka mbjellë bukën
e kohëve të lashta bukën e kohëve moderne
Ju thashë shtatë vjet babën tim e ka pritur Ajo
shtatëdhjeteshtatë vjet E ka pritur tërë jetën
e ai s'ka ardhur e Ajo një mot është shndërruar
në emër kuptimi Ju thashë atë drita e ka verbuar
një ditë prej ditësh duke u ngjitur një briri Ju thashë

TANI BABAI IM FLET NË EMËR TË NJERËZIMIT

Tani babai im flet në midis të sheshit të kuq flet
prej goje flaka i del e tymi ia mbulon fytyrën e vrëntë
në mermer

zogu në cep të krahut i çerdhon e fyelli i Rexhës
kohët e largëta ia kujton kohët e varura në muze të
heshtjeve

Tani babai im flet në emër të njerëzimit të proletarëve
bota ia heq kapelën në Paris e në Moskë bota i përulet
në Romë e në Uashington E poetët vargje shkruajnë për të
në Europë e në Amerikë në Azi e në Afrikë

Shkruajnë e ëndërrojnë

ta shohin njëherë atë trim në hava të ngjitur në kalë
Tani babai im flet në midis të sheshit të kuq flet
në qytetin e punëtorëve profesori i universitetit marksist
mban ligjërata për të E në një vend diellor
diku në veri o në jug në lindje o në perëndim
të planetës një shkollë merr emrin e tij e një popull
kremton përvjetorin e pavarësisë vetveten e quan Unë
Tani babai im flet në midis sheshit të kuq flet
një çift i ri i panjohur kushedi prej nga
kalon natën me shi nën pallton e tij të bronxtë
e nën qiellin e ditës njëqindvjeçare bëj roje unë
dhe ju kërkoi vetëm ndjesë për babën tim hero
si për njeri si për njeri si për njeri

E KUQJA

Në syrin tim gacë çilet e mbyllet sheshi i kuq
përditë përnatë mbyllet e çilet në syrin tim gacë
po kjo botë po kjo botë ku udhëton vallë

RREMBI I DRITËS

KENI LINDUR KOT DHE NUK JENI NJERËZ THAN'

Mustafa Bakiut

Keni lindur kot dhe nuk jeni njerëz, than' –
të kota i keni këngët e vajtimet për bukë e vatan.

trimat do t'i qesë blerimi në fushë, zjarri
e xhelatët e litarët kanë për t'ju pritur.

E ne qëndruam mbi kufitë e durimit,
pritëm gjatë te një lumë që ikte nën urë.

NJËHERË VONË I RA DIKUJT NDËRMEND

Nënës Terbeshi

Njëherë vonë i ra dikujt ndërmend:

zemrën e kujt do ta ketë kjo pranverë,
syrin e cilës drenushë, të cilit skifter?

– Tim bir, vajzës sime – shtoi një plakë
që përcillte kahmot valën e lumit nën urë.

Sapo prilli ia behu e vajti si lajmtari i kuq,
pyeti një tjetër: Ku janë, a do të kthehen?

Plaka qetas buzëqeshi e urtas foli atë botë:
– Shkoni, shkoni, fëmijët e mi diej janë bërë –

dhe një flakë me zjarr e shpirt e shoi
e kurrkush s’e pa se kah shkoi.

Thonë fuqia e kësaj toke prej gjiut të saj buron.

ÇKA T'I PËSHPËRIS KUJTIMIT TË VARUR
NË RREMB DRITE

Emin Durakut

E tash, çka të them për syrin tënd profil lirie?
Çka t'i pëshpëris kujtimit të varur në rremb drite?

A t'i them: ne njerëzit jemi shumë të çuditshëm,
botën e kallim për një fjalë e s'njohim zot as drejt...

O, kur menë thirrjet e trimave në male e litarë
të kërkova larg harrimit. E përtej trëndafileve të gjakut,

përtej sa detrave e plepave verbova natën gjakatare
me kocin e vdekjes,
me duart e njerëzve të untë dhe veten vodha në jetë...

E tash, çka të them për syrin tënd profil lirie?

KALORËS KALORSI NË KËTË FUSHË
PAS ASNJË PLEP E HIJE

Hysni Zajmit

Kalorës kalorsi e gjatë është rruga deri në diell.
Apo sheh: stuhia uluron e shpirtin than në gjallërim,

sytha ëndrre herr e krah zogu përgjak në këtë qiell
pa asnjë ylber e re shiu, etjen sa për ta shuar –

në këtë qiell të ftohët plot këmbonare e thika
që në kob zgjojnë largësitë e përgjumta përditë përnatë...

O, mëkatet e mia kur do t'ju ik sysh njëherë –

Hesht i madh në këngën time të vogël
e unë të krahasoj me lua, të krahasoj me lule

kalorës kalorsi në këtë fushë pa asnjë plep e hije.

DROJ SE KURRGJË S'DO TË MBESË
PAS KËTIJ BLERIMI

In memoriam, Ibrahim Zherkës

Si vashën agimi e zgjoi korriku Dukagjinin në kaltri,
si vashën agimi... E ti – a e ndjeve, oj?

Të jesh diçka në këtë gufim shpirti që i ngjet
flakës e ujit të harlisur, që i ngjet këngës e vajit
nuk është vdekje, është lindje i dashuri im, lindje –

E ne ç'ishim pos bajraqe në duart e tymtarëve,
pos buzëqeshje e vëllezërve të besatuar një mot...

O, të rëndë e paske heshtjen, o tokë e dhimbës simel!

Si vashën agimi e zgjoi korriku Dukagjinin në kaltri
e në sytë e verës së hutuar e varruan qiellin e djegur
këmbonarët e pikllimit... E ti – a i ndjeve, oj?

Droj se kurr gjë s'do të mbesë pas këtij blerimi.

NJË SHPIRT KULLË E LARTË

Esad Mekulit

E pashë një shpirt si shetiste
rrugëve të dashurisë
rrugëve të dhimbës E pashë
unë e di ç'i fliste zogut në qiell

E pashë një shpirt kur u bë gur
në livadhin tim të kositur
në ballë iu përflak një yll
e në qiell thellë thellë u fik

një shpirt kullë e lartë e bukurisë

LARGËSITË

THIRRJE

I.

Pëllumbi im, kush të dërgoi,
pëllumbi im
– krahlehtë me atë fjalë?

Ti je më i miri pëllumb,
pëllumbi im
– më i shpejti në këtë dhe!

Prej nga në fushë të ballit tim,
Pëllumbi im
– kah po fluturon?

Ti je më i bukuri pëllumb
pëllumbi im
– krahtyer për atë fjalë!

Medet, po më kallen sytë,
pëllumbi im
– Lilin me çka do ta shoh?

Kush do t'ia dërgojë letrën time të mbrëmë,
pëllumbi im
– i pikëlluar?

II.

Shikoj njerëzit
shtigjeve të jetës –
kurrkund fytyra jote.

Në prag pres dallëndyshet
që pranverën thërrasin –
kurrkund krahu yt.

Dielli në ballin tim
m'i ngroh kaçurrelat –
kurrkund rrezja jote.

Dëgjoj këngën e zogut
që përshëndeti lindjen e agimit –
kurrkund zëri yt.

Lili,
livadh i kositur i harrimit.

III.

Trenisht nisa të bërtas në vete,
po ti askund s'm'u përgjegje

U dogje në largësina e caqe të jetës
bukë e kripë në grushta të vocërrakut shtrënguar

e lejleku i shtëpisë qiellin shpoi
krahët i përgjaku duke të kërkuar.

po ti kurrkund s'je, s'po të shoh, o vëlla!
Medet, në bregoren tonë po digjet blerimi.

IV.

Natë. Qyteti im flen. Ereniku fshihet në mua
e ylberi në sy. Unë qe sa kohë po të thërras,
po bredh – e ti ku je, o Lili?
As qeni i shtëpisë sime më s'leh,
as pijaneci plak s'shan rrugëve,
thua të gjithë njerëzit janë shndërruar në mua
– në ëndrra dhe në dëshira.

*

Ëndërrova veten. Kalli dola të shetis.
E ti sa afër je: me duart e zgjatura,
sa embël më grish
në jetë – me ata sy të mëdhenj, me atë zemër zogul!
Sa larg je prej kësaj nate të kallur
që në nisjen time!

*

Lili, po t'isha unë – ti, e ti unë
kurrë nuk do të vuanim njëri për tjetrin,
kurrë nuk do të vdisnim po t'isha unë – ti, e ti unë.

*

Ky është qyteti ynë
në përralla dite që e mësuam si këngën,
si lutjen për jetë.
Ky është, si thonë, zgjidhja me shumë vete

ku secili gjen vetveten.
Këtu për secilin rruga e fatit vijzohet drejt lindjes
më të re
që kurrë nuk kthen te vdekja e parë
që kurrë nuk kthen te vdekja e parë.
Ky është qyteti im
– kënga e gjithkujt.

*

Ti je ai që natë për natë në ballin tim fluturon
dhe më ik si ëndërr e shkurtë në të gdhirë të agimit.
Ti je ai që natë për natë më le me buzë të kallura
e më tret, më tretë në kujtime.

Ti je ai që më bën të jetoj
për të nesërmen e harrimit!

*

... sonte kurrë s'do të thirrja
po të mos vuaja për ty,

– kurrë,
Lili!

*

Ç'po kërcasin qeshjet e agimit. Ereniku
prapë qiti syrin diku në një përrallë
Qeni i shtëpisë sime leh e qyteti im po zgjohet.
... Hej, kujt t'ia këndoj këngën e ëndrrës së mbrëmë,
kujt t'ia hap zemrën më shumë se ty, më shumë se vetes.
kend ta quaj me emrin tënd pas sa vitesh
– Lili, nëse kurrë nuk kthen...

E – qeni im po leh: në mua apo në syrin e fshehur
pas kullës?

V.

A të kujtohet Ereniku
nën Urën e Tabakut?

Një shtegut hyhej
një i ri çilej
e kurrë s'mbyllej.

A të kujtohet Ereniku
rrëzës së Çabratit si ikte?

Ti kërkoi vetveten në fundin e tij,
unë flakën në syrin tënd.

VI.

Koha e dashurisë iku.

Koha e shirave ardhi.

VII.

lëshoj rrënjë
s'arrihem, –

digjem
përtrihem –

vëllai im
vëllai im,

le të lindem
të mos vdes

Amen! Amen!

VIII.

Më ka marrë malli me të pa duke qeshur, o vëlla,
me dëgjue këngën e gjakut tënd të pa va,
si këngën e qiellit kur nis të reshë;
me të pa duke luajtur me guraleca,
në valë të Erenikut duke u larë –
më ka marrë malli me të pa, o vëlla, asht i thyer...

Hapat e tu trokëllojnë te porta e gurit,
Rrafshit të Dukagjinit dëgjoj ende zërin tënd –
e nëna sa herë më buzëqesh në mua zgjohen
dhimbët e resh e resh diku lart mbi mua e botë –
Ereniku shtratin ndërrohet e ik e ik vrap
nën Urën e Tabakut, po ti kurrkund s'je o vëlla –
asht i thyer!

IX.

Si blerimin – Çabrati
ndjeu vdekjen tënde –
atë natë,

thellë
si blerimin.

Në brryla të plepave
zogjtë krahët i thyen në fluturim –
atë natë,

o, trup i kallur
nën qiellin e dashur të Dukagjinit!

MOS MË HARRO

*Ferid Grezdës, gjimnazist, që fashistët e mbytën
mizorisht më 2 prill 1943 në Gjakovë*

I.

e mortaja s'shetiti
se kullat'in
mbyllur

e sytë
dalë
në kodër

II.

çka s'mund të ndodhë

në krahë të djathtë
të lind dielli

në krah të majtë
ta përbin gjarpëri

në lule të ballit
e palulja

nën këmbë
e padukshmja

oh ethet e fatit
në këtë tokë të shtjerë në thumb

III.

natë unë përsëri shoh
përsëri po rritem me plepa
po kjo heshtje

shtëpia ime e kallur
si i trembi zogjtë në çabrat

o putheni putheni
këtë natë prilli

flakë le të kallet
prej puthjeve tona

natë shtëpia ime
syshpelle

IV.

gjak e lak
lak e gjak hak
gjak gjak
lak e lak e lak
hak e gjak
shtëpi me prak
e shtëpi pa prak

lak
gjak
hak

vdekja në mua
krua
uua

V.

plepat kanë rënë në erenik
janë zhytur në ujë

oh etja
si më dogj
e plepat kanë rënë në erenik

VI.

në sy të mi
s'ka lot

ka zjarre

në duar të mia
s'ka dorëza zotërinjsh

ka gjurmë zinxhirësh
kafshime gjarpërinjsh

në fjalë të mia
s'ka lutje

tërmete
ka

kala

VII.

liri
na dashurove thellë
në deje gjakun na kalle

na bëre të flasim me vetveten

me majet e tua të paarritshme
jemi rritur
liri

liri
shi
hi

po ky lumë në ballin tim
shok mos më harro

VIII.

në këtë natë prilli
ç'po më përbin qielli
oh nënë

vëlla
ma afro ballin
ta puth

ereniku ç'po ushton në damarë të mi

IX.

në sy të mi
dita harroi të çelë
e nata të ikë

X.

luftëtarë të botës
rreshtohuni nën rrashtën time të shpuar

në ashtin tonë
do të varet ujku i zi

XI.

po mortaja s'shetiti
se kullat 'in
mbyllur

e sytë
dalë
në kodër

E EMRIN E KA DASHURI

ASNJË FJALË TË KEQE PËR PRINDËRIT TANË

Asnjë fjalë të keqe për prindërit tanë, njerëz të mirë, asnjë fjalë se kujtimi na i verbon sytë e gjatë digjet një flakë mbi kulmet tona. Asnjë fjalë se koha jonë për ta, se koha e fëmijëve tanë që ëndërr e bukur si liria dhe përrallë e pabesueshme për zotrinjtë tanë tregimi për ne: se si ne fëmijët e “njerëzve me bishta” do të ngrehim kulla të reja të Babilonit e piramide më të larta se të Keopsit, se si do të na thërrasin lavërtarë të kohëve të mirësisë, të dritës dhe varrtarë modernë të së keqes e zotrave të braktisur në theqafje... Asnjë fjalë të keqe për prindërit tanë, njerëz të mirë, asnjë fjalë, kujtimi shi rigon; asnjë fjalë – se koha e tyre i ngjau urisë e vdekjes, etjes së shpirtit të sëmurë e assesi e assesi zhgëndrrës sonë dhe shi pas sa bjeshkë udhëtimi doli dielli mbi kulmet tona, doli mbi koka të zgjebosura e Hamëzalia në titërr të ledinës pa frikë shikon lejlekun në oxhak të kullës së tymosur se do t’ia mbysë fqiu ynë i çmendur, fqiu ynë i shituar. O, asnjë fjalë të keqe për prindërit tanë, njerëz të mirë, asnjë fjalë Se kujtimi na i verbon sytë e gjatë digjet një flakë mbi kulmet tona.

E EMRIN E KA DASHURI

Për këtë tokë gjaku ka rrjedhur e prindërit tanë
kryet e kanë lënë, kambana të mëdha kanë mbetur
në jetën tonë për këtë tokë ata që nuk janë më –
e ju si të doni quajeni këtë tokë muze e emrin e ka
dashuri e emrin e ka na; o si të doni quajeni
po asnjë fjalë të keqe për prindërit tanë
njerëz të mirë, asnjë fjalë se kujtimi na i verbon sytë.
Asnjë fjalë të keqe thashë se ata gjithçka janë bërë
për këtë tokë, se ata ishin trima mbi trima
dhe – nëse ndokush ka vdekur duke kënduar
ata vdiqën majë hanxharit të dushmanit me këngë në gojë,
nëse ndokush s’ka kthyer nga rruga – ata i kërkuam,
nëse ndokush ka dashuruar me jetë lirinë – ata ishin.
Fjala e tyre kurrë para turpit s’u dridh, huq kurrë s’shkoi
për këtë tokë si rrufeja vrau në lakmi gjaku –
e ju si të doni quajeni këtë tokë muze e emrin e ka
dashuri e emrin e ka na; o, si të doni quajeni
po asnjë fjalë të keqe për prindërit tanë,
njerëz të mirë, asnjë fjalë se ata prora ditur kanë
të jetojnë e vdesin për këtë tokë, të dashurojnë e urrejnë;
se ata mikun kurrë në besë nuk e kanë prerë
dhe nëse ndokush ka vdekur duke kënduar
ata vdiqën majë hanxharit të dushmanit me këngë në gojë,

nëse ndokush s'ka kthyer nga rruga – ata i kërkuam,
nëse ndokush me jetë ka dashuruar lirinë – ata ishin
e ju si të doni quajeni këtë tokë muze e emrin e ka
dashuri e emrin e ka na; o si të doni vetëm mallkim jo –
se për këtë gjaku ka rrjedhur, i nxehtë ka rrjedhur...

PËRRALLË E PABESUESHME

E pabesueshme ishte loja jonë me zjarr një mot,
shkuarja pas një nuse të plakur e kthimi ynë në bukuri;
dashuria e Rrushës pas syrit arshik të Zek trimit
e pabesueshme ishte si loja e deleve pas ujkut
dhe fyellit të dalldisur në zemër të pyllit;
i papritur ishte pastaj aktrimi i bareshës syzezë në një teatër
që la malet e tbanët një ditë vere e iku në qytet
për t'u bërë yll i artit të shtatë – ose kënga e Orfeut

pas flokëve të arta të dritës, që verboi ujkun e trimëroi qingjin
mbi vijë të mullirit shtatë gurësh... O, qëlloje, qëlloje
thikë e gjakut atë zemër ziliqare që nuk të veshë në petka mirësie
e s'të këndon si këngë lirie kah të shkel këmba e syri e mendja,
qëlloje se koha e prindërve tanë ishte nata e ujkut të plaguar,
varr i truar i ëndrrave e tregimi për ne, e tregimi për ne;
se si do të ngrëhim kulla të dritës e ura të fshehta mes njerëzve,
se si do ta shkruajmë abetaren e parë për fëmijët tanë të etshëm
për dritë e dije –
përrallë e pabesueshme për zotrinjtë tanë që na shtrëngonin
lakun në qafë.

HAJDE SHOK POET E KËNDOJE NJË KËNGË

Ec tani pash besën e mos e quaj këngë jetën tonë e
udhëtimin e gjatë
nëpër kohë e mote sa lindja jonë; në korin e femrave
ec e mos hyrë të këndosh krah e m'krah me Hamëzalinë,
ujk i vjetër,
me heroin e punës e me mësuesen Afërditë, ec e mos u ndal
para qyteteve, fshatrave, para tytmtarëve më të larta se
piramida e Keopsit –
që ngritur i kemi ne brigadat e reja të jetës.
O, hajde shok poet e këndoje një këngë
që kurrë s'është dëgjuar në këto troje gjaku e nami,
hajde e falja zemrën kësaj toke të etshme për dashuri
e blerim, falja pa hile

si prindërit tanë që u bënë gjithçka të jetojmë ne,
fara e mallkuar –
mos ik shok poet para asaj dore të djaloshit flokëverdhë
si dorë e shkathhtë artisti që u pikturon gjërave të çuditshme
të shekullit vetullën e hënës e fyellin e Rexhës, mos ik
para thjeshtësive të jetës sonë e gjurmëve të revolucioneve –
o, nxirre një këngë shok poet, nxirre kah del shpirti,
fjala vjen për atë minatorin e Trepçës që në skenë e jetë
betohet në lirinë e vet

se ka për t'ia shpaluar shtatë palë dheut gjersa t'ia vjedhë
gramin e fundit të arit për dhëmbin e thyer të Tanushës
së malit...

Hajde shok poet e këndoje një këngë
që kurrë s'është dëgjuar në këto troje gjaku e nami –
këndoje e harroje të kaluarën e gozhduar në tëmtha shekujsh,
këndoje një këngë shok poet si di ti kur gjaku të kall
në damarë

e falja zemrën kësaj toke të etshme për dashuri e besim,
falja pa hile se në stacionin tjetër udhëtimi i ri na pret.

E MATEMI ME LARGËSITË E PASKAJSHME TË MUNDIT TONË

Përditë vërshon jeta e dashurisë sonë
kullohen bebzat e lindjeve lehonë;

përditë ecim me nga një vdekje më pak
me zjarr në shpirt me të kaluarën në lak;

përditë shkruhet legjenda për ne – diell,
përditë lindim më të rinj nën këtë qiell

bëhemi dashuri, bukë e fjalë lirie,
bëhemi konak bese, trimërie e ura ardhmërie.

Përditë lindim prej dashurisë sonë
e matemi me largësitë e paskajshme të mundit tonë.

THUNDRAT U RANË

QIELLI NË DEF

I.

në bebza palova rrembat e kohëve
po rrugët kurrë s'i sosa –

rrugët e paemërta.

II.

A ka këngë më të bukur
se kënga ime,

a ka këngë më të dhimbshme
se kënga ime

e pa sosur

prej muzgjeve në agime,
prej lotëve në qeshje –

vetëm kënga ime
vetëm kënga ime.

III.

Kurrkush prej nesh vuajtjet njëri tjetrit s'ia dimë
(se vuajtja është lëmsh i tjerë
në boshtet e zemrave) –
e unë jam vuajtje e pakënduar
në ditët e përbira
me ngërçat e idhët të këngës pikëlluese
– e dehur me vaje e qeshje të mia.

IV.

Unë jam gruaja më e bukur
e më e shëmtuar
në mahallë

unë jam e çnjerëzuar –
rininë ua fala rrugëve të unta,

në dalldisjen time
kur thimthat e gjinjve
i shkurtova për dashuri.

unë jam dashnorja e gjithkujt.

V.

Kam kënduar, prej agimit në agim, në shtëpinë e panjohur
shejtani im,
prej agimit në agim...

E shtatë mahallë kanë pirë kafën e syve të mi filxhan,
shtatë mahallë janë dehur me gurgullimat e gazit dhe vajit tim.
Pas darke, gju më gju, kam kënduar

në odë të burrave, me burra –
shejtani im,
gju më gju...

Dhe, vaj, kanë qeshur me vajin tim
prej agimit në agim!

VI.

Trenisht e më bukur
këndova këngën tënde
voglushi im.

Njëqind çika të mahallës mblodha në dasëm,
njëqind zana mali të shkelën gjersa u kall përëndimi
e dashi me brirë, e dashi me brirë
shpoi qiellin në def si zembrën tënde, si zembrën tënde!

Qerpikët e tu – dallëndyshe të dehura, voglushi im;
faqet e tua kuq si alli – dallëndyshe të trenuara;
rinia jote lis me rremba – dallëndyshe të hutuara –
hej, ndër njëqind çika të mahallës nusen ta zgjodha, kopili im...

Kur të vijnë krushqit, kur të vijnë krushqit
do ta kall edhe çerdhen e dashurisë
në lule të ballit.

VII.

Gjithkund të kërkova edhe në harrim,
dashuria ime,
gjithkund.

Zotin shava
kur nuk munda
të të krijoj më të bukur se n'ëndërr.

Gjithkund të kërkova shejtani im,
gjithkund –
hej, zemrën po ma coptojnë rrugët.

Qe i vetmi gëzim që më dehe, i vetmi diell që më nxeve.

VIII.

Na përbinë,
dashuria ime,
në shtatë mahallë, na përbinë –

e treqind krushqi në hijen e ballit tim pinë
treqind krushqi lodruan nëpër ballin tim pa kufi.

Na shkelën e na herrën e s'shterrëm,
dashuria ime,
syshkyer
ballërrëzuar –

Në hijen e ballit tim pinë,
thundrat kuajve
u ranë.

IX.

Thirri pemtarët
të ujiten fushat e shpirtit të tharë,

balli yt të fladitet
me zemrën time!

Thirri të mos shuhen sytë e zez
dhe ditët –

se edhe kur të plakem
se edhe kur të plakem

do të jemi të rinj –
thirri, se u dogja flakë!

Oh, valë ç'm'i shembe brigjet...

X.

Krejt verën e hardhisë ma pive,
shejtani im,
krejt –

bora e parë në flokë të mi.

Tërë jetën më shkele, lule herre,
shejtani im,
pa fije gazi e mëshire në sy.

Tërë jetën të dehur më rroke,
shejtani im –
miku dhe armiku im!

XI.

Ç'na duhet kozmetika?

Ç'patëm në kurtha mbet,
shejtani im, shejtani im –

kozmetika ç'na duhet?

Fytyra fytyra bota shket në haxhillëk

XII

Nëse shpëtoj ndonjëherë
nga hapësitë e panjohura
do të më shpëtoj dashuria –

oh dashuria ime si s'më gjet akoma!

NË MES TË NJERËZVE

E JETA RRODHI AR

lindi me karrige në gji

jetoj me kokë të huaj

e varrosën me karrige përbri

mi mi gjirizi thi i zi mi

e jeta prapë

rrodhi

ar

BALADË BASHKËKOHËSE

imzot në kopshtin tim
le të bjerë shi me buri
popullin mund ta përshëndes
nga vila çaj duke pi'

imzot në hambarin tim
bukë le të ketë sa mot sa vjet
popullit mund t'i flas
nga autoja djalli le të pëlçasë

imzot shumëçka më fale
po më le njëherë të jetoj
populli mund të gjallërojë
edhe pa mua... oh arësye si më le

SHOKËT

të njejtën ditë shkelën malin
me të njejtën lugë hëngrën

të njejtën këngë kënduan
të njejtën valle lozën

me qiri me pishë Marksini lexuan

në të njejtën krua ujë pinë
pas të njejtës dhëlpër shtinë

nëpër të njejtën udhë u kthyen
shumë gjëra ndodhën pastaj në kullë

idealin e lanë e shpërlanë
e krehën e shkrehën njëditëpërnjëditë

me trenin e parë në farkatore e dërguan

fytyrën ia teleisën
dhembë të arit i vunë

pastaj nëpër botë mori vrapin

shi një mot Sokol Trimi
jug shkeli lindje kuqloi

eshtra la në perëndim
varrin në veri oh ai qiell i ftohët

e në rrëzë të një bjeshke

Burrec Turreci karrigë ndërroi
vilë ngriti me ca frëngji

qumësht shpenish piu
ai telall i marrë i par' në mahallë

e te njejtën ditë shkelën malin
të njejtën ditë u kthyen

me të njejtat shenja

TË VDEKURIT

me pishë e qiri zotën kërkuar
në tokë as në qiell s'e gjetën
kulla ëndrrash ngritën pastaj
kudo atë rrenacak imituan

gryka lanë pas male kaptuan
këmbë as duar s'patën asnjëherë
në katër rrotë kohën shkuan
po megjithatë kurrë s'jetuan

VDEKJA VILLTE JETRA TË REJA

vdiste ndokush në kullë
një më pak pëshpëritnin pas mureve të lashta
ujku hynte në përralla tona

vdiste ndokush

ne hapnim frëngji të reja
veten e ndjenim më të fortë
më afër tokës

vdiste ndokush në kullë
në tymin e kohëve
shkruanim emrat

prej përrallave tona fluturonte e fluturonte
një lejlek i kuq
shpirt hiqte majë heshtjes

një më pak pëshpëritnin pas mureve të lashta
e vdekja
villte jetra të reja

VRAPI PAS VETVETES

duke kërkuar vetveten më ndoq pylli
tani jam më i madh se kjo flakë mbi kokën time
e më i urtë se ajo fjalë e zënë pisk
në mes dhëmbëve të rënë rreth Kullës

duke kërkuar vetveten zbulova pyllin në një odë
shi kushedi për të satën herë tani
po u tregoj fëmijëve kryeneçë të lagjes së pafjetur
përrallën mbi Kësulkuqen dhe Ujkun

NGADHNJIMTARI

populli im flen Mbi bjeshkë Në fushë Mbi ashtin tonë
unë rri zgjuar pranë kokës së tij
luaj me rrufe
çoj dashuri me stuhi
populli im flen
në jug në veri
mbroj kokën e tij nga sorrat nga ujqit
hap Derën e Kullës dal në Botë
u bie fyejve deri në çmendi
këmbonarët trand
rreth vetvetes
populli im flen Mbi flakë Në shi Mbi ashtin tonë
unë rri zgjuar pranë kokës së tij
mbush pushkë zbraz vdekje
gjuaj dhelpra tremb korba
emra emra
emra
gdhend në Librin e Shenjtë
populli im flen
zgjuar Unë rri
luftëtari

LUTJE

më duani njerëz të mi
kështu çfarë jam –

ndryshe s'mund të jem Unë

NË MES TË NJERËZVE

po ia kthej shpinën romantikës
nga zotrat liroj këngën time

në mes të njerëzve le të heqë shpirt
nëse s'mundet të jetojë më mirë se Unë

po ia heq perden e hekurt rrenës
gji i jap të vërtetës te një Urë

në mes të njerëzve po zbres me një shpatë
gjuhën le të ma shkurtojnë nëse i tradhtoj

SHËNIM

Përmbledhja “THIRRJE” për herë të parë doli në vitin 1961 në botim të “Jetës së re”, kurse në vitin 1968 “Bagdalla” e Krushevcit e nxori në gjuhën serbokroate në përkthim të Esad Mekulit dhe Mirko Gashit. Ish ky botim i plotësuar. Tani, pas trembëdhjetë vjetësh nga botimi i parë, po botohet për herë të dytë e kthyer në gjuhën e unjisuar, e përpunuar dhe e plotësuar. Megjithëse pjesa dërmuese e poezive u shkruan dhe u botuan sapo isha nxënës i gjimnazit të Gjakovës, disa poezi, gjersa u vendosen këtu, shëtiten prej përmbledhjes në përmbledhje (herë në “Dhimbë e bukur” të vitit 1967, herë në “Sampo”) dhe gjatë udhëtimit pësuan ndonjë ndryshim që në të vërtetë ndikoi në harmonizimin e kësaj përmbledhje. Andaj, “Thirrje” u rilindën dhe tani për tani mendoj se udhëtimi i tyre mori fund.

A. P.
20 tetor 1973
Prishtinë

SHAMIJAT E PËRSHËNDETJEVE

Rilindja, Prishtinë, 1963

FLAMUR SHEKUJSH

NJERZIT

Ditën e parë dashunohen në ngjyra;
Ditën e dytë andrrojnë me fluturue;
Ditën e tretë kërkojnë me qenë dëshira;

Jo lule – me i këputë era dhe stinë;
Jo zjarre – me i shkymë shinat dhe motet;
Jo kumbona – me i trembë zogjt dhe qingjat.

KANGËS

Bahu qiell i dëshirës sime,
Bahu blerimi dhe flaka ime,
Bahu balli dhe jeta e çdo shekulli.

N'mes diejve, ernave e luleve
Ta kërkoj ngjyrën dhe emnin,
– N'mes zogjve e lindjeve.

Bahu rrëfe t'mos vrasë bukurija
As syni i askujt,
Bahu unë – fjala ime.

Të ndiej si rritesh nëpër zemra e ndërgjegje.
O, qe sa vjet andrroj
Me ta gjetë buzëqeshjen ma të bukur në këtë dhé.

DASHUNI DIELLORE

Përditë vërshon jeta e dashunisë sonë,
E rriten bebzat e lindjeve të kuqe.

Përditë ecim me nga një vdekje ma pak
T'blertë në zemër e të zjarrtë në shpirt.

Përditë shkruhet legjenda për ne.
Përditë lindim ma të rij nën këtë qiell.

E bahemi dashuni, bukë e diej,
E bahemi lumej e ura breznije.

Përditë lind njeriu
Prej dashunis sonë – si diell.

SHKRUEJE EMNIN TIM

MËNGJESI. ZGJIMI

Me çka me të peshue,
Me sy apo me zemër,
– Me çka?

O, tanë botën
Kanga jote e zgjoi
Dhe kaltrija.

Me çka me të peshue,
Me sy apo me zemër,
– Me çka?

O, tana dritaret e jetës
Krah e m'krah m'i çeli
Andrra jote.

LUTJA. PËRSHËNDETJA

Ngrehe ballin mbi kaltrin e lindjeve,
Si dallëndyshë fluturo, kanga ime,
Bota kufi s'ka për ty.

Ngrehe urën e dashunis deri në diell –
Vetëm ajo na lidh me jetë,
Vetëm ajo na lidh me njerëz.

Zbrit si zogu në krahun e vashës
E zgjidhju barkat peshkatarëve të vonuem,
Kur vi i madh si lum.

TI JE...

Si me u bâ për ty
Vetëm lum njëherë –
Me m'quejt' dashuni njerzit.

Si me u bâ për ty
Vetëm diell njëherë –
Me m'quejt' jetë fëmijt.

Si me u bâ për ty
Vetëm blerim njëherë –
Me m'quejt flakë vashat.

O' në ty kurrkush
S'guxon me vu dorë,
– Kurrkush!

SHKRUEJE EMNIN TIM

Ta këndova kangën ma të bukur në mituni
Që dija me kangtue për dritat e ballit.

Dhe betua jam n'bukën e njerëzve t'mij.
N'zjarrin e votrës sime. Atdhe.

Se kurr synin s'kam me ta luejtë n'trathti,
Se kurr për ty kot s'kam me i shurdhue shekujt.

Rritu n'mue, o, rritun n'mue sa bjeshka,
Shkrueje emnin tim n'qiellin Tand të kaltërt:

Ku ballin e njeriut t'urtë e ke diell,
Ku ballin e vashës e ke re të bardhë.

N'livadhet tua gjurmzon edhe jeta ime
Me u rritë me lule, me u plakë me kangë.

ÇABRATI. UNË

Si endacak mbas fluturave t'bardha
I përçolla agimet kaltroshe
T'moshës s'mitun. Dallëndyshet e vjetve t'mij.

Dhe prita njëherë të vetme:
Me i ngja vetëm blerimit e kangës s'njeriut,
Me thirrë vehten e derdhun livadheve t'jetës.

Se ty kurr s'mujta
Me të nxjerrë krejt prej zemre
– Me harrue bukurinë e fëminisë sime...

DRINI I BARDHË. URA E FSHEJT

Në mes bjeshkëve përbihet i qetë
Si koha nëpër unazat e jetës sonë
– Drini i bardhë n’Rrafshin e Dukagjinit.

Brigjeve t’bardha
Ngrihen kullat e dashunisë
– Kullat, si n’pralla.

Me u dash’nue, o mik
Duhesh me u betue
Si në zemrën time.

Te Ura e Fshejtë rrjedh
Edhe fëminija ime
– Me etje të shueme.

SHAMIJAT E PËRSHËNDETJEVE

Secili udhtar n'botë
Përsëndet në mënyrë t'vet
– Secili prej nesh.

Kurse unë gjithmonë kam mendue
Njeriun me përsëndetë
Me buzëqeshje ma të nxehtë

N'minutat e ndamjeve të zakonshme
Që t'mallëngjejnë,
Që t'gëzojnë.

E ju – si të doni:
Sytë e udhtarëve n'kalim përherë i keni
Dhe shamijat e përsëndetjeve n'duer.

SHIU LE T'NA DASHUNOJË

NË PRITJE

Të kam pritë sa harrue kam emnin
Dhe ngjyrën time.
Të kam pritë mbas çdo gëzimi,
Oj kangë e moçmueme,
Ty që u dhe vjetve të mij
Ngjyrën e harrimit.
Të kam pritë,
– Pa ty në mue s'ka qetsi
As kanga s'e ka emnin e vet.

ETJE PËRMALLIMI

Babës

Babë, si loti të piku balli në çerdhen e zogjve.

– Medet, ku do të lahen sytë e shpresat e jetës sime

Me emnin tand në buzët tona të shkrueme prore
Të përcollëm i madh e i vogël, i dashtuni im!

Lavra e moteve rritet tash nëpër fytyrën time
Hullij të panumërta peng t'etjes për ty tue m'lanë.

E unë në kujtime këtij trolli pash e m'pash i bi'
Me femininë e djegun, me mallin e rimun në gji...

Babë, kurr ma dielli yt nuk shndrit n'këto konaqe,
– Medet, kurr ma, o plaku im, sytë e tu n'jetën time!

MALLËNGJIMI

Nanë, t'kujtoj si vedin se thellë n'ty jetoj
Dhe digjem n'dashni.
Sa herë moti ballin ma shkel, andrroj
Prehnin tand plot jetë e risi.

SYTË

Sytë i kam çerdhe –
N'pendla t'plumbave t'bardhë
Flejnë rrugët dhe njerzit,
Si fijet e mëndafshit.

Sytë i kam det –
Në ta puthen jetnat e mallueme,
Që vijjnë e shkojnë me barkat e caqeve
T'agimeve dhe t'muzgjeve.

Sytë i kam dashni –
Nën duvakun e moteve,
Që shuejnë shkrumbin e jetës,
Që ndezin pishat e jetës.

Sytë i kam yj vizllues, gamba t'blertë,
Në ta gjiron bota
Me dhimbje e dëshira,
Që i mbaj në mes lindjeve dhe paslindjeve t'mija.

KALI I DASHUNIS

E ngrehu kryet vrik
Si engjull i bardhë,
Rrugët e qiellit m'i fshi.

Unë – qysh moti,
Kur u dashunova së pari,
Po e ndjeki yllin tim.

Tanë qiellin e shkeli,
Kur kryet e uli
Në livadhin tim.

Medet, kah shkuen dasmorët?
Si me i mbërrijtë?
Haj, kali im i gjorë.

BETEJA E THYEME

Në jetën bonjake, shpeshërë
Kam vjellë pikllime, g'zime –
Dhe n'bujtina t'vehtes përherë
Kam mbetë betejë e thyeme.

LINDJA ME VIZLAT E NJI SHEKULLI

N'akullnajat e detit
Rrëshqasin jeta dhe vdekja.
Pulëbardhat sharrojnë në thellsi
Dhe n'gosti t'stuhive
Gëzimi puth gëzimin
E fuqia e vdekun shkrihet n'kangë.

BUKURIJA

E zgjata dorën në livadh lulen me këputë,
“Mos! – fqi u im i dashtun më bërtiti –
Ka me u vyshkël!”
Unë qava për saksinë time të thatë.

E zgjata hapin, kalin e bardhë me mbërri –
Vashën e andrrueme kaheërë.
“Mos!” – përsëri m’u gjegj fqi.
Unë qava me mallë edhe atëherë.

E hudha dorën në gjithsi me pikëllim –
Çel e mshel sytë dritë m’a bâ.
“I lumi ti!” – dikush m’bërtiti n’përçafim
E kurrë tjetër s’pashë as ndjeva mâ.

– Sot e at ditë kudo po e kërkoj fqiun tim të mirë.

SHIU

Hesht!

Qan njeriu ma i miri, ma i urti,
Njeriu i tokës së djegun, tokës së vetmueme
– Aq i andrruem, aq i dashtun për botën e lulen.

Hesht,
Të lutem, o mkatar,
Dhe hape zemrën!

Shiu le t'na rrisi si kallij t'artë,
Shiu le t'na sjelli qetsinë,
Shiu le t'na dashunojë.

DETI

Kush të njef, thot se je njena nga ato prrallat
E njimijë e një netëve – ose syni i hyrive.

Ti je zemërgjanë e shpirt fisniku,
Si fantazija e ke rrugën, e lirë.

Ti mundesh me qenë edhe dëshirë
Për ata që nuk dëshirojnë me t'pagzue.

Ti mundesh me qenë edhe andërr
Për mkatarët e botës që t'andërrojnë me t'pasë n'gji

Aty ku kurrkush s't'andrron e qet synin e madh si t'prillit
Dhe ernat i zgjon prej thasëve të zotit Eol.

I ban të madh e të vogël të dashunojnë si dritat e ballit
Të nderojnë si Zotin, të puthin si Dashunin e Bukën.

Në krahun e djathtë të paça përherë,
Në krahun e majtë vashën e gurrën e kangës!

O, cili zog t'ra kah balli e s'u ndal një trohë me pushue?
Cila zemër t' tha se s'je për te?...

Ti shtrihesh breg e m'breg si vasha
Kur vijnë anijet, o det, me të shkelë, dhe njerzit!

GAZELA E DASHUNIS

DASHUNIJA E PARË

Si stuhi e fortë mali
Zgjove n'mu'
Kangën e fjetun.

Dhe nuk di
Pse deshte me m'i marrë
Edhe sytë e mij të përlotun.

Sot si zjarri
Më dogj malli
Për ty,

Që s'bredh ma livadheve
Të vesueme
Me lulen time n'gji.

KANGA E ZOGJVE T'UNTË

1.

Në qytetin e botës vjen njeriu i kallun etjes
Prej së largu,
Si reja me shi:

I merr ditët e veta,
I merr
Netët e përgjumta.

Birit t'zotit i len vrragë në zemër,
Pse kaq vonë ka ardhë me trenin e fundit –
Pse s'ka këcye në trenin e parë...

Po, të tillë janë njerzit
Në jetë,
– Të marrë për dashuni

Kurse ti – s'kam mendue se ke me qenë
Qetsija ime e braktisun,
– Tanushë e vargut të kërkuem!

2.

Me këndue për botën është vështirë,
Po ndalju vrapin ditëve
E mos luej me zjarr.

Dashuni s'është vetëm me jetue,
Agime me pa, tue lindë:
Të kuqe, të blerta, të bardha.

Dashuni është
Edhe me vujtë
– Randë e gjatë...

Mos ia prish bukurinë qiellit!
O, unë nuk kam zemër
Njeriut me i thanë lamtumirë

3.

Mëkatin e ditëve shtegtare që na vodhën
Mos ia fal as vehtes, oj vashë,
– Si dikur për dashuninë tonë s’kemi m’u betue.

Me u ba kangë e bukë e zogjve t’untë
S’ka gja ma të randë,
S’ka gja ma të dashtun.

(Si me u ba bjeshkë e pikllimit,
Si me u ba
Dritë e synit!)

Në pasqyrën e jetës
Secili
Jemi – vitrina dëshirash.

4.

Me zgjimin e pranverës
Kalle n'mue
Beharin e jetës.

Dhe lulen e vjetëve t'kaltërt
Ma hudhe në dorë
Për kujtim.

Por, një ditë, ndoshta,
Ke me m'i mëshefë gjithë çelsat
Në thundrën e kalit...

E unë,
Si djerradit' i dejun
Kam me puthë rrugën e vetmisë sime.

5.

Këtë qytet nuk e njof. Miqt e mij, ku jeni që më thatë:
“Sytë e diellit prorre ke me i pasë, dhe zemrën e shkambit!”
Që më thatë gjithçka për sytë e mij. Ku jeni miqt e mij.
Që çdo vjet ma mësuat nga një kangë të re?

– Voglush i dashtun, a banon këtu Marija Kral?
Unë për herë të parë po vij në këtë qytet...

Si kam me ikë? Si kam me ardhë te ju, miqt e mij të vjetër?
Në mue, këtu, përnatë po shembet nga një beden dëshirash,
E kurrkush, si duket, s’po din se si ka ardhë, si do të kalojë!

Medet, kah me ia mbajtë? Vetëm. Ju, pse po i përshëndetni
hijet e mija
Aq pikllueshëm, aq dhimbshëm! Pse po u faleni
tue heshtë për mu’?

E dij - ajo s’banon në këtë qytet! Miqt e mij të paharrueshëm,
Pse s’ma thueni emnin? Miqt e mij të mirë, ku jeni?
Furtuna, në flakë e n’ujna shëndrrue në mu’, hatashëm, po luen,
N’kaçurrela t’mija muzgu i vjetve po bie. Në kupë të qiellit
Lojën time po e akton zogu i diellit

Ndërsa unë, ende po endem në këtë qytet shtëpinë time
tue kërkue...

Miqt e mij të rij, ma thueni emnin? Shokë, m'sillni prej këtuhi!

Po bindem oj vashë, se s'je ma as n'kangën time, as n'vajin tim!

6.

Sonte njisoj âsht me vdekë dhe me jetu, Marije,
Krejt njisoj: si me t'urrejtë, si me t'dashunue.

Sonte jam ba konak i udhtarëve e çerdhe e zogjve të lodhun.
Jam ba zot e dreq në kët skaj t'kosmosit – me t'pritë.

Sonte po ndij si shushuron edhe nata e shamjeve t'mija,
Nata e çelsave, e bravave t'thyeme. Si po m'len kanga.

Sonte njisoj âsht me vdekë dhe me jetue, Marije,
Krejt njisoj: si me ta thanë emnin, si me t'a harrue.

Shtëpija ime ka sharrue n'qetsi e n'andrra,
Lagja ime laramane po kotet pa asnji simfoni dashunije.

Kend me grishë për ujë? Asnji krue te buza ime!
Kujt me ia kërkue një pikë ujë? Asnji vashë

S'ka qëllue, medet – me ma zgjatë dorën prej blerimit.
O, të lutem, lene at vocërrak, t'm' shajë n'gjuhën e tij t'bukur,
Prej zemrës; lene at trim t'm'i nxjerrë t'gjitha thikat e botës –
Në dashuninë time due me qenë i amshuem!

Sonte si zog kange është mbyllë nata n'kuvli, Marije,
– O, çfarë kange din me këndue përveç kangës që e due si ty, njeri.

Si ta thonë emnin, moj shejtane? Kah po vjen,
O, zog krahshkruem që po ngreh n'mu' tanden fole?

Te konaku im i vetmuem tash bjen një tjetër kumbonë
Një tjetër pranverë çelë, por droj asnjë kalorës s'do t'mbërrijë

M'e pru fjalën e besës s'dhanun, shaminë tande t'bardhë,
Me sjellë unazën e gëzimit maje shpate, prej shtatë drynave.

Sonte njisoj është me vdekë dhe me jetue, Marije,
Krejt njisoj: si me t'dashunue, si me t'urrejtë.

7.

Kalleni blerimin tim, nëse doni,
Nëse doni mos e zgjoni
Asnji vajzë e grue prej gjumit,
Asnji trim sykaltër. Zjarri le t'i kallë!

Kallni, nëse doni, edhe të lashtat
E njizet vjetve të mij,
Edhe shtatë pishat e ballit tim – nëse doni,
Mposhtni edhe flamujt e kangëve të mijs...

Vetëm, o njerzit e mij të dashtun,
Ma ktheni kupën e kaltër të qetsisë:

N'ballin zeshkan mos m'i numëroni hullit
E stinëve të harrueme rrugëve të jetës
Kah përvidhem prej syve të botës;
Lulen e mbjellun për njeriun e ri

Mos ma këputni prej zemrës,
As kangën e fillueme
Për fëmininë time të vjedhun
Buzë Erenikut – se vetëm atëherë

Kam me pasë edhe vdekjen time
– Buzëqeshje të drandafilltë
Mbi vorrin e kujtimeve.

Në jetë dashunojmë, o njerëz –
Vetëm me mundë urrejtjen,
Vetëm me harrue vdekjen.

*

E kujt është kjo letër në dorën time?
O, zjarr rrëfenash, si me të shue
Pos me ujin e shijnat e vjetve t'mij,

Pos me kaltërinë e ditës që hapin po ma nxen!

*

Njeri – kanga jote e re
Krahët e skyfterit –
Dita me ditë po m'i jep!

GAZELA E DASHUNIS

Më ballsamosni, kush â trim,
Në kët trung mani!

Çika e parë
Të më kujtojë si vllaun.

Çika e dytë
T'ma thot emnin.

Çika e tretë
T'i marri malet.

Më ballsamosni, kush â trim!
Due ta vizatoj dashuninë dhe bukën.

KUJTIMI

Ndodhi një herë
E u bana peshk
Në buzën tande.
– A të kujtohet?

Sa lumi vërshoi
At pranverë,
Sa s'la shtëpi pa rrëxue
E beden...

Kur stuhia e vjetve
I këputi dëshirat n'bel,
E mëshefe synin n'vetmi
E qave si fëmija.

Po, pse s'ma hoqe
Edhe këtë patkua prej ballit –
Po ma le të digjem
Si pisha në jetë tue të kërkue?

BISTRICA

Rrjedh Bistrica,
Rrjedh edhe n'mu'.

Uji i ftoftë si ndamja jonë,
Uji i kthjellët si loti ynë.

Nget Bistrica,
Nget edhe në mu'.

Vashë, si me ardhë
Nëse nuk do të vijsh?

NDAMJA NË SYNIN E PRITJES

Në dy brigjet e lumit pa asnjë urë
Tash ngrihet
Nga një shtëpi e vetmueme.

Në stacionin e dëshirave
Ajo pret e pret.

Trenat kalojnë dhe njerzit
Me nga një copë heshtje.

Në dy brigjet e lumit pa asnjë urë
Tash njeriun e harruam kamot
E kafshon kanga e vet.

ANDRRA

E çel derën e agimit një vashë
Del në kopshtije si hana në qiell.

Një vogëlush i vonuam pa pritje e kujtue
E tremb zogun e ramë në degë.
Djali vrik i këcen një rëje në qafë –
Ik' e i mbetet vashës pikë në zemër.

SHËNIM I REDAKSISË

Vendimi për botimin e veprës së plotë të Ali Podrimjes u paralajmërua që në mbledhjen komemorative të mbajtur në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 23 korrik 2012, pas marrjes së lajmit për vdekjen e papritur të poetit në pyjet e Lodevit, në jug të Francës, ku kishte shkuar të përfaqësonte poezinë shqipe në festivalin *Voix de la méditerranée*. E premtoi kryetari i ASHAK, akademik Hivzi Islami, si hap të parë të vlerësimit të trashëgimisë së tij dhe si dëshmi se përkujdesja për këtë trashëgimi do të jetë e menjëhershme dhe e vazhdueshme.

Redaksia që u themelua pas kësaj (akademik Ali Aliu, redaktor përgjegjës, akademikët Rexhep Ismajli, Eqrem Basha, Sabri Hamiti dhe Mehmet Kraja, anëtarë), mori detyrën dhe zotimin që botimi të dalë në përvjetorin e parë të kësaj humbjeje të madhe për poezinë shqipe, e bindur se nuk do të jetë aq lehtë e thjeshtë, sa ç'mund të mendohet në fillim.

Podrimja në të gjallë të vet ka botuar me dhjetra vëllime me poezi, prozë, ese e publicistikë, si dhe po aq me përzgjedhje të poezisë së tij. Është përkthyer në shumë gjuhë të botës, ka shkruar e rishkruar variante, ka ripunuar dhe rikrijuar të njëjtat vjersha, i bindur se “për të gjallë të autorit, krijimi është qenie ‘e gjallë’, lëvizëse. Shkaku i një fjale, figure a strofe, autorët shpesh u kthehen teksteve.” Por ai vetë asnjëherë nuk kishte bërë përpjekje

ta përmbliedhte gjithë opusin, edhe pse këtë mundësi e kishte pasur gjithmonë.

Prandaj puna e redaksisë nuk ishte aq e lehtë...

Gjatë mbledhjes dhe sistemimit të materialit u ballafaquam me dilema e vështirësi jo vetëm pse as autori nuk kishte bërë sintezën e veprës së tij dhe as që kishte dhënë ndonjëherë projeksione të tilla, por sepse shpesh ribotimet dhe rikrijimet e të njëjtave libra, sidomos në fillimet e tij, sillnin pothuaj gjithnjë varianta që ndryshonin mjaft nga e para.

Prandaj vendosëm që krahas përmbledhjes së parë “Thirrje” (1961) të sillnim ribotimin dhe ripërpunimin e vetë autorit (1973), i cili jo vetëm se e kishte kthyer atë në normën letrare, por e kishte ndryshuar tërësisht. I tillë ishte edhe ribotimi (po nga autori) i “Dhimbë e bukur”, në fund të të cilit ai kishte inkuadruar dhe një cikël nga libri më i ri “Sampo”. Një rikomponim dhe rikëndim ndryshe ishte dhe “Hija e tokës” që nxori asokohe gazeta e studentëve *Bota e re*, e që përfshinte vjershat nga librat e parë me poezi, por që tani vinin të riparua në një vëllim *ndryshe*.

Lexuesi do ta vërejë se ndonjë nga këto vjersha përsëritet nga disa herë, por asnjëherë në variant të njëjtë dhe jo gjithmonë në kontekst, në rrethana e në cikle të njëjta. Pastaj, disa nga ato do të përsëriten edhe një herë tek antologjia e hartuar nën kujdesin e kritikut dhe studiuesit Bashkim Kuçuku dhe e botuar nga *Toena* në Tiranë, të cilën e sjellim të plotë si sintezën më të gjerë të veprës poetike të Podrimjes.

Natyrisht, veprime të tilla dukeshin të domosdoshme në komponimin e vëllimeve më të hershme. Ato të mëvonshmet janë dhënë ndonjëherë në variantet e para, duke humbur mbase diçka të shtuar në versionet tjera, e ndonjëherë në ato të mëvonshmet, siç është rasti me “Lum Lumi”, vëllimi më shpesh i ribotuar, të cilin po e sjellim sipas njërit nga botimet e fundit.

Redaksia ka qenë gjithmonë e vetëdijshme se duke dashur ta japë sa më të plotë Podrimjen duhet të lejojë përsëritje, varianta, ripunime e rikrijime, në veçanti tek vëllimet e poezisë, e bindur se

kështu do të ofrojë pasqyrë më complete të përpjekjes së vazhdueshme të poetit për të përsosur e sublimuar opusin e tij. Por këtë logjikë nuk e kemi ndjekur te vëllimet e prozës, eseve dhe publicistikës, sado që edhe aty hasim rilexime e ripunime të mëvonshme.

Sidoqoftë, përpjekja jonë ishte që ta jepnim sa më të gjerë opusin e tij, duke shpresuar se do të lëmë sa më pak brumë jasht këtij botimi dhe të bindur se me kaq nuk i kemi përmbyllur përpjekjet, mbase edhe për botimin kritik të veprës së Ali Podrimjes.

Prill, 2013

Redaksia

BIOGRAFIA

Lindi më 28 gusht 1942 në Gjakovë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin Filozofik, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 1966 zë punë në gazetën e përditshme “Rilindja”, në rubrikën e kulturës. Më 1976, në Edicionin e Botimeve “Rilindja” udhëheq bibliotekat: Poezia shqipe, Letërsia botërore dhe Letërsitë e ish-bashkësisë jugosllave. Është anëtar i LSHK dhe i PEN-it shqiptar.

Në vitin 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i ASHAK, ndërsa në vitin 2000 zgjidhet anëtar i rregullt.

Me shkrime filloi të merret qysh si gjimnazist. Poezinë e parë *Arabja* e botoi në revistën “Jeta e re” nr. 4, 1957. Po kjo revistë në vitin 1961 botoi dhe librin e tij të parë *Thirrje*. Në përkthim të poetit Esat Mekuli u botua, me plotësime, edhe në gjuhën serbokroate (1968). Përmbledhja *Thirrje* në vitin 1971 u bë kartuç në Tiranë, për shkak të disa poezive “hermetike”. Ekzemplari i shpëtuar nga një poet tiranas, udhëtoi deri te autori hiç më pak se 20 vjet.

Pos poezive, Podrimja shkroi ese e tregime. Bashkëpunoi me të gjitha revistat e fletushkat në gjuhën shqipe brenda dhe jashtë atdheut. Ishte fitues i shpërblimeve të ndryshme letrare. Në vitin 1999, në Shtutgart të Gjermanisë, u nderua me çmimin e mirënjohur letrar *Nikolas Linan*. Librat e tij janë botuar, ribotuar dhe përkthyer në disa gjuhë. Ishte i pranishëm në shumë manifestime ndërkombëtare.

Vdiq më 21.7.2012 në Lodëve të Francës, ku merrte pjesë në festivalin e poezisë Voix de la Méditerranée.

BIBLIOGRAFIA

Libra të botuar:

Thirrje, poezi, *Jeta e Re*, Prishtinë, 1961 ;

- *Naim Frashëri*, Tiranë, 1972, zgjedhje Pandeli Koçi. Botimi i parë i këtij libri u bë karton;
- *Botim i autorit, Prishtinë, 1973.*

Shamiat e përshëndetjeve, *Rilindja*, Prishtinë, 1963.

Loja nën diell, tregime, *Jeta e re*, Prishtinë, 1967.

Dhimbë e bukur, poezi, *Rilindja*, Prishtinë, 1967.

- *Botim i autorit, Prishtinë, 1973.*

Sampo, poezi, *Rilindja*, Prishtinë, 1969;

Hija e tokës, *Bota e re*, Prishtinë, 1971.

Torzo, poezi, *Rilindja*, Prishtinë, 1971;

- *botimi i dytë, pashtënia Ibrahim Rugova, 1979.*

Folja, poezi, *Rilindja*, Prishtinë, 1973.

Credo, poezi, *Rilindja*, Prishtinë, 1976.

Sampo 2, *Flaka e vëllazërimit, Shkup 1980.*

Poezi, lektyrë shkollore, Prishtinë, 1978, 1985.

Drejtpeshimi, poezi e zgjedhur, parathënia Ibrahim Rugova, *Rilindja*, Prishtinë, 1981.

Lum Lumi, poezi, *Rilindja*, Prishtinë, 1982, 1986, 1990;

- *Toena*, Tiranë, 2003, botimi i katërt dhe i pestë, parathënia dr. Bashkim Kuçuku;
- *Rozafa*, Prishtinë, 2003 ;
- *Libri Shkollor*, Prishtinë, 2012;
- *Botimet Koha, Prishtinë, 2012.*

Fundi i gëzuar, poezi, *Rilindja*, Prishtinë, 1988;

- *PEN-i i Kosovës*, Prishtinë, 2012.

Zari, poezi, *Rilindja*, Prishtinë, 1990.

Në bisht të sorrës, poezi, *Art-Pena*, Prishtinë, 1994.

Buzëqeshja në kafaz, *Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë*, Tiranë, 1994.

- *Dukagjini*, Pejë, 1995.

- Tkurja e Atdheut**, ese dhe të paharruarat, *Konica 95*, Tetovë, 1996;
 - *Toena*, Tiranë, 2004.
- Libri që nuk mbyllet**, ese, *Rilindja*, Prishtinë, 1997.
- Ishulli Albania**, *Rilindja*, Prishtinë, 1998;
 - poezi e zgjedhur, parathënia Visar Zhiti, *Onufri*, 2004;
 - botimi plotësuar, AIKID, Prishtinë, 2006.
- Burgu i hapur**, *Rilindja*, Prishtinë, 1998.
- Harakiri**, ese, shënime nga esnafi dhe një miniroman, *Rilindja*, Prishtinë, 1999.
- Dielli i zi**, ese, *Rilindja*, Prishtinë, 2000.
- Poema**, Enti i Teksteve, Prishtinë, 1979, parathënia Hysni Hoxha.
- Poezi**, *Naim Frashëri*, Tiranë, 1986, zgjodhën Dritëro Agolli, Xheva-hir Spahiu, parathënia D. Agolli.
- Ëndrra kallxohet në mëngjes**, *Rilindja*, Prishtinë, 2001.
- Litari i ankthit**, poezi e zgjedhur, parathënia Bashkim Kuçuku, *Toena*, Tiranë 2002.
- Antologji personale**, *Ora*, Tiranë, 2002.
- Kush do ta vrasë ujkun**, *Alba-Ass*, Tiranë, 2002. Zgjedhjen dhe parathënieën akademik Ali Aliu.
- Te guri i Prevezës**, Parathënia Bashkim Kuçuku, *Arbëria*, Tiranë, 2003.
- Letra nga të vdekurit**, ese dhe persiatje, *Toena*, Tiranë 2004.
- Pikë e zezë në blu**, poezi, *Onufri*, 2005.
- Sfidë harrimit**, ese, parathënia Bashkim Kuçuku, *Onufri*, Tiranë, 2006.
- Gjumi i tokës**, poezi e zgjedhur, *Ideart*, Tiranë, 2007.
- Fundi i mitit**, tregime, parathënia Sadik Bejko, *Onufri*, 2007.
- Libri mbi të qenit**, poezi e zgjedhur, Brezi 9, Tetovë, 2008 ;
 - *PEN Qendra*, Prishtinë, 2009, parathënia Fatos Arapi.
- Libra të botuar në gjuhë të huaja:**
- Dozivi**, *Bagdala*, Krushevac, 1968, zgjodhi dhe përktheu në serbokroatisht Esad Mekuli.

- Lili i našata sloboda**, *Nova Makedonija*, Shkup, 1968, përktheu në maqedonisht Video Podgorec.
- U bogu su nazreli zmiju**, *Nolit*, Beograd, 1972, zgjodhi dhe përktheu serbokroatisht Vehap Shita.
- Suzenj pesmi**, *Lipa*, Kopar, 1976, zgjodhi dhe përktheu sllovenisht Ciril Zlobec.
- Sonot što produlžuva**, *Misla*, Shkup, 1978, përkthyen në maqedonisht Gane Todorovski, Adem Gajtani.
- Zatim belo**, *Matica srpska*, Novi Sad, 1978, përkthyen në serbokroatisht Esad Mekuli, Rexhep Ismajli.
- Ravnoteža**, *Gradina*, Nish, përktheu në serbokroatisht Mirko Gashi.
- Pesmi**, (me Enver Gjerqekun, Azem Shkrelin, Rrahman Dedajn) *Mladinska knjiga*, Lubjanë, 1980, përktheu në sllovenisht Ciril Zlobec.
- Poesie per Lumi**, *La sfinge*, Napoli, 1984, zgjodhi dhe përktheu në italisht Giacomo Scotti.
- Gene bir basina**, Yalçin yayinlari, Stamboll, 1985, përktheu në turqisht Hasan Merxhan.
- Den Wolf satteln**, *Straelener*, 1986, zgjodhi dhe përktheu në gjermanisht Hans Joachim Lanksch.
- Baladi Kosova**, *Tekyn*, Stamboll, 1986, përktheu në turqisht Nexhati Zekeria.
- Živjeti**, *Vesilin Masleša*, Sarajevë, 1987, përkthyen në serbokroatisht Hasan Mekuli, Shkëlzen Maliqi.
- Nyngtalan Ko**, *Forum*, Novi Sad, 1988; zgjodhën dhe përkthyen në hungarisht Acs Karoly dhe Feher Ferenc.
- Icb saddle das Ross den Tod**, Klagenfurt/ Salzburg, 1991, zgjodhi dhe përktheu në gjermanisht Hans Joachim Lanksch.
- Zyc**, *Orfen*, Varshavë, 1993, zgjodhi e përktheu polonisht Mazllum Saneja, pashënia Dorota Horodyska.
- Das Lächeln im Käfig / Buzëqeshja në kafaz**, Klagenfurt/ Salzburg, 1993, përktheu në gjermanisht Hans Joachim Lanksch, u ribotua në vitin 2004.
- Wandern mit dem Wolf**, *Weiser Verlag*, Klagenfurt-Salzburg, 1992, zgjodhi dhe përktheu në gjermanisht Hans Joachim Lanksch.

- Poeti Europei**, *Centro Italiano Arte e Cultura*, CIAC- Roma, 1998.
- Who whill slay the wolf**, selected Poetry by Ali Podrimja, *Gjonlekaj Publishing*, Nju Jork, 2000; zgjedhi, përktheu në anglisht dhe shkroi parathënien Robert Elsie.
- Défaut de verbe**, Edition bilingue, *Cheyne*, Le Chambon-sur-Lignon, 2000, përktheu në frëngjisht dhe shkroi parathënien Aleksandër Zoto.
- Skradziony płomień**, Pogranicze, Seyni, 2007, wybólad z języka albańskiego i poslowie Mazllum Saneja, opracowanie i współpraca Ewa Śmetańska.
- Deserto invasivo**, poesie, a cura di Bl ;erina Suta, De Angelis Editore, Avelino, 2007.
- Cartea ce mu se inchide**, Anthologie de autor, *Librarium Haemus*, Bukuresht, 2007, antologare, traducere și aparat critic de Kopi Kÿçyku cu o prefață de Ardian-Christian Kuciuk.
- Flaka e vjedhur/La flamme volée**, *L'Arbre à paroles / Residences*, 2010, traduction Vasil Çapeçi, adaptation Francis Chenot.
- Ο σχιomenos xapησ** (Harta e grisur), *Eolika grammata*, 2011, përktheu në greqisht Iliaz Bobaj.

Panorama dhe antologji në gjuhë të tjera:

- Vertikale** (me Augustin Stipçeviqin), *Matica Hrvatska*, Split, 1970.
- Duboko je korijenje** (me Augustin Stipçeviqin), *Matica Hrvatska*, Split, 1970.
- Le parole rinate – Fjalë të rilindura –** (me Giacomo Scottin), *Rilindja*, 1970.
- Kiša u jednoj legendi**, *Prosveta*, Beograd, 1973.
- Bez glagola**, *August Cesarec*, Zagreb 1978.
- Poezia acontemporano di Jugoslavia**, *Libertates*, Pançevë 1978.
- Poeti albanesi in Jugoslavia**, *La Battana*, Rijeka 1978.
- Dega e pikëlluar** (me Sabri Hamitin), *Rilindja*, 1979, në gjuhët gjermane, frenge, angleze dhe arabe (Kuvajt).

Poezia revolucionare e popujve të Jugosllavisë (me P. Matvejeviqin, H. Tahmishiqin, S. Llukiçin, C. Zlobecin), *Spektri*, Zagreb 1981.

I prezantuar në panorama e antologji shqiptare e në gjuhë të huaja:

Shtigjet e qëndresës - Stazama otpora, grup përpiluesish, *Klubi i punëtorëve letrarë të Kosovës*, Prishtinë 1961.

Pesme gorke i ponosne, Esad Mekuli, *Nolit*, Beograd 1962.

Panoramë e letërsisë bashkëkohore shqipe në Jugosllavi, grup përpiluesish, *Enti i Teksteve*, Prishtinë 1964.

Pravostoina, zgjodhi dhe shkroi parathënien Ali Aliu, përkthyen A. Gajtani dhe G. Todorovski, *Makedonska knjiga*, Shkup 1968.

Tregime të sotme shqiptare, Ramiz Kelmendi, Prishtinë 1969

Për ty, poezi nga Kosova, *Naim Frashëri*, Tiranë 1969

Rrëfimi i njeriut me samar, panoramë e tregimit kosovar, *Naim Frashëri*, Tiranë 1970.

Antologjia e lirikës shqipe, Rexhep Qosja, Rilindja, 1970 dhe *Enti i Teksteve 1985*.

Cormoran y delfin, 14 poetë kosovarë në spanjisht, Buenos Aires, 1971.

E di një fjalë prej gurit, Antologji e poezisë së Kosovës, *Naim Frashëri*, 1972.

Trolli betohet, Hysni Hoxha, *Rilindja*, 1975.

Beschëingter Stein, zgjedhur e përkthyer nga Ina Jun Brod. Poezi bashkëkohore e Jugosllavisë, Wien - Mynchen, 1976.

Regen in einer Legende, zgjedhur e përkthyer nga Dieter Schon, *Heiligenhof* 1977.

Antologjia e poezisë së sotme shqipe në Jugosllavi, zgjodhi dhe parathënien e shkroi Ali Aliu, *Jehona*, Shkup 1977.

Oçi kamena – Sytë e gurit, Esad Mekuli, *Pobjeda*, Titograd, 1978.

Arnaut siiri antolojisi, Ibrahim Rugova, *Tan*, Prishtinë, 1979.

Sla po soncu, Hasan Mekuli, *Cankarjeva Založba*, Lubjanë 1979.

- Antologija i komentari savremene jugoslovenske misaone poezije**, Grafos, Beograd 1980.
- Antologija e poezisë jugosllave**, Nexhati Zekerija, *Xhem*, Stamboll 1980.
- Ljudi bez oružja**, Antiratna poezija, *Nova knjiga*, Beograd 1985.
- Iz savremene albanske poezije**, Agim Vinca, *Sarajevski dani poezije*, Sarajevë 1985.
- Pisatelji za demokracijo**, *Mladinska knjiga*, Lubjanë 1989.
- Antologija e poezisë së përshpirtshme shqipe**, zgjodhi Anton Nikë Berisha, 1999, Prishtinë.
- Anthologie de la poésie albanaise**, par Alexandre Zotos, Comp'Act, Lyon, 1998.
- Poesia del Kossovo**, përgatiti Daniele Giancane, italisht, 1999.
- Gui anh ngoi Kosovo**, Përshëndetje vëllezërve kosovarë, vietnamisht, Trinn Bay, 1999.
- Antologija e poezisë shqipe shek. XX**, zgjodhi e përktheu, Kun Stassejns, Amsterdam, 2000.
- Antologji e poezisë shqipe**, Ali Aliu, 2000, Tetovë, Albin, Tiranë, 2002.
- Katër poetë**, zgjodhi e përgatiti Xhevahir Spahiu, Tiranë, 2000.
- Nie jest za późnona miłość**, Antlogia poezji albanskiej XX wieku, përgatiti dhe përktheu Mazllum Saneja, Pogranicze, Sejny, 2005.
- Ali Podrimja, **A split stone**, An Antholgy of Albanian Poets of Kosova, translated from Albanian, Avni Spahiu, DIÇ & Rozafa, Prishtinë, 2006.
- Luan Topçiu, **O antologie a poeziei albaneze**, Editura Privirea, Bukuresht, 2007.
- Bashkim Kuçuku, **Ukraden plamen**, Antologija albanske poezije, përktheu Qazim Muja, DANU, Podgorica, 2009.
- Prezentohet dhe në këto gjuhë:**

Në suedisht: **Ornarna och bergen**, antologji e poezisë shqipe, zgjodhi e përktheu Ullmar Qvick, Forlaget rallarros, Gëteborg, 1979; **Regnbågens Sångar**, antologji e poezisë së

- Jugosllavisë, zgjedhur e përkthyer nga poeti i njohur rumun Jon Milliosh, Symposion, Stockholm Stehag 1990.
- Në lituanisht: **Dzejas diena**, Poezi e popujve të botës, LIESMA, Riga, 1977.
- Në rusisht: **Molodoj poeti jugoslavi**, Molodia gvardia, Moskë 1974; *Poezija sovremenoj Jugoslaviji* (Hud. Literatura, Moskë 1981.
- Në polonisht: **Vetëm Itaka mbetet**, (Mazllom Saneja), Varshavë 1993.
- Në anglisht: **An elysive eagle soars**, zgjedhur e përkthyer nga dr. Robert Elsie, Unesco, Forest books, London-Boston, 1993; **Roads lead only one way** (Poezia bashkëkohore e Kosovës), përpilues Mensur Raifi, Prishtinë, *Shoqata e përkthyesëve të Kosovës*, 1988. Përkthyes John Hodgson.
- Në hungarisht: **Acs Karoly, Kiasott kard**, antologji e poezisë së popujve të Jugosllavisë, *Forum*, Novi Sad, 1985.
- Në arabisht: **Antologjia e poezisë shqipe**, zgjedhur e përkthyer nga dr. Muhamet Mufaku dhe botuar në Damask e Kuvajt, 1981
- Në gjermanisht: Zieh dich zurürk in den vers homers, përgatiti: Dr. Mensur Raifi. Përktheu në gjuhën gjermane Oda Buchholz, botim i *Shoqatës së përkthyesve të Kosovës*, Prishtinë, 1988. Zersplit tertes Europa, **Schwalenberg, Lippe, 1993**; Zwischen feder und Fahne (**Andreas P. Pittler dhe Helena Verdel**), **Libër esesh, grup autorësh, Pucis, Wien 1993**. Das Buch der Rander-Lyrik (**Antologji e Evropës Qëndrore**), **Weiser Verlag, Klagenfurt-Salzburg, 1995**; Literatur und Kunst im Heinrich Boll – Haus Langenbroich, **Rheinland - Verlag GmbH-Köln, 1995**.
- Në frëngjisht: **Les cahiers**, poezia shqipe, zgjedhur e përkthyer nga Alexander Zoto, 1989.
- Voix albanaises dans la nuit**, poezia shqipe, zgjedhur e përkthyer nga Alexander Zoto, 1991.

Ka përzgjedhur dhe botuar, me parathënie e pasthënie/ese për shkrimtarët e veprat:

Vorea Ujko, **Ankthi**, 1979.

Fatos Arapit, tre libra, **Fatet, Kaltërsina dhe Dafina në shi** (1971, 1979 dhe 1985).

Ismail Kadare, **Buzëqeshje mbi botën**, 1980.

Dritëro Agolli, **Të pagjumët**, 1982.

Sulejman Mato, **Jeta në dy kohë**, 1982.

Abdylazis Islami, **Maje malesh**, 1983.

Xhevahir Spahiu, **Tek rrënja e fjalës**, 1988, etj.

Eqrem Basha **Brymë në zemër**, 1989.

Agim Ramadani, **Një jetë tjetër**, 2000.

Azem Shkreli, **Zjarr i fjetur**, *Toena*, Tiranë, 2001.

Azem Shkreli, **Dhembja e pikes**, Albas, Shkup, 2002.

Fatos Arapi, **Eklipsi i ëndrrës**, *Toena*, Tiranë, 2002.

Take të larta (Antologji e krijueseve shqiptare), *Sfinga*, Prishtinë, 2000.

Dritaren lëre hapur, *Rozafa*, Prishtinë, 2002 (zgjedhje e poetëve të viteve 80).

E frikshme dhe e bukur, *Rozafa*, Prishtinë, 2003 (zgjedhje e poetëve të viteve 80).

I kujt je, Atdhe? *Rozafa*, Prishtinë, 2003 (zgjedhje e poetëve të viteve 90).

Sadik Bejko, **Perëndim me pak natë**, *Toena*, Tiranë, 2004.

Eni vjen prej Çamërie, antologji, parathënia Ismail Kadare, *Rozafa - Arbëria*, 2004,

Mihal Hanxhari, **Gdhend një statujë**, *Toena*, Tiranë, 2005.

Një gur i çarë, Sprovë antologjike për Kosovën, *DÇJ-Rozafa*, 2005; si dhe *Toena*, Tiranë, 2005, parathënia Bashkim Kuçuku.

Shpërblimet:

I Dhjetorit, i Nëntorit, (i qytetit të Prishtinës), i Rilindjes, i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, i Fjalës etj.

Çmimi ndërkombëtar për poezi “Nikolaus Lenau”, Shtutgart, Gjermani, 1999.

Çmimi ndërkombëtar “Liburna”, Durrës, 2005.

Çmimi Azem Shkreli.

Çmimi i Organizatës Kulturore Ndërkombëtare “Kafeneja e Ideve”, Salaminë, Greqi, 2011.

Poezitë e tij janë përkthyer edhe në hebraisht, danisht, norvegjisht, holandisht, greqisht, çekisht, bullgarisht etj. Po ashtu janë botuar në revista si *Poesis 93*, *Mediteran* (Paris), *Neue Sirene* (Mynhen), *Neue literatur* (Ofefenbach), *Literatur und kritik* (Salzburg), *Hid* (Novi Sad), *Slobodnost* (Lubjanë), *Impegno 80* (Itali, Mazara del Vallo, Frapani), *Literatura na sviacie* (Varshavë), *Život* (Sarajevë), *Nëntori dhe Letërsia shqipe* (Tiranë), *Književnost* (Beograd) etj.

Për poezinë e tij kanë shkruar Hasan Mekuli, Vehap Shita, Ali Aliu, Rexhep Qosja, Rexhep Ismajli, Bashkim Kuçuku, Xhezair Abazi, Gani Bobi, Mensur Raifi, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Agim Vinca, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Anton Berisha, Basri Çapriqi, Hysni Hoxha, Sali Bashota, Visar Zhiti, Faruk Myrtaj, Milazim Krasniqi, Vehbi Bala, Perikli Jorgoni, Abdullah Konushevc, Rrahman Paçarizi, Jusuf Buxhovi, Ali D. Jasiqi, Shefqet Riza, Asllan Selmani, Ismail Syla e shumë të tjerë, shqiptarë e të huaj.

PËRMBAJTJA

NJË ZË THELLËSISHT TRONDITËS DHE
I MPREHTË, BARTËS I DHEMBJES SË TË GJITHËVE.....7

THIRRJE (1961).....25

THIRRJE27

Thirrje I-VIII27

Mos më harro I-VII.....36

METOHIS.....46

Unë i pari.....46

Malli.....47

Betimi.....48

Edhe.....49

Sa herë.....50

Me u dashunue në ty.....51

Due të jemë.....52

Nata.....53

Lindja e madhe54

Madhshtija.....55

MAGJUPJA.....56

Magjupja I-VII56

ILIRIANA	65
Stuhija	65
Kurr at emën.....	66
Kjo natë.....	67
Iliriana.....	68
Kurr, o Iliriane.....	69
Dita e vonueme	70
At ditë	71
Lamtumirë, Iliriane	73
Dëshira.....	74
THIRRJE (1973).....	75
PËRMENDORJA	77
Unë.....	77
Kulla.....	78
Përmendorja e një prindi.....	80
Çka mund të them tjetër për babën tim.....	81
Tani babai im flet në emër të njerëzimit.....	83
E kuqja.....	84
RREMBI I DRITËS	85
Keni lindur kot dhe nuk jeni njerëz than'.....	85
Njëherë vonë i ra dikujt ndërmend	86
Çka t'i pëshpëris kujtimit të varur në rremb drite	87
Kalorës kalorsi në këtë fushë pas asnjë plep e hije.....	88
Droj se kurr gjë s'do të mbesë pas këtij blerimi.....	89
Një shpirt kullë e lartë	90
LARGËSITË	91
Thirrje I – IX.....	91
Mos më harro I – XI	102

E EMRIN E KA DASHURI	109
Asnjë fjalë të keqe për prindërit tanë	109
E emrin e ka dashuri.....	110
Përrallë e pabesueshme	112
Hajde shok poet e këndoje një këngë	113
E matemi me largësitë e paskajshme të mundit tonë.....	115
THUNDRAT U RANË.....	116
Qielli në def I – XII.....	116
NË MES TË NJERËZVE.....	125
E jeta rrodhi ar	125
Baladë bashkëkohëse	126
Shokët	127
Të vdekurit	129
Vdekja villte jetra të reja.....	130
Vrapi pas vetvetes	131
Ngadhënjimtari.....	132
Lutje	133
Në mes të njerëzve.....	134
SHËNIM.....	135
SHAMIJAT E PËRSHËNDETJEVE	137
FLAMUR SHEKUJSH	139
Njerzit	139
Kangës	140
Dashuni diellore	141
SHKRUEJE EMNIN TIM.....	142
Mëngjezi. Zgjimi.....	142
Lutja. Përshëndetja.....	143

Ti je	144
Shkrueje emnin tim	145
Çabrati. Unë	146
Drini i Bardhë. Ura e Fshejtë	147
Shamijat e përshëndetjeve.....	148
SHIU LE T'NA DASHUNOJË	149
Në pritje.....	149
Etje për mallimi	150
Mallëngjimi.....	151
Sytë.....	152
Kali i dashunis	153
Beteja e thyeme.....	154
Lindja me vizlat e nji shekulli	155
Bukurija	156
Shiu.....	157
Deti.....	158
GAZELA E DASHUNIS.....	160
Dashunija e parë.....	160
Kanga e zogjve t'untë	161
Gazela e dashunis.....	171
Kujtimi.....	172
Bistrica	173
Ndamja në synin e pritjes.....	174
Andra.....	175
SHËNIM I REDAKSISË	177
BIOGRAFIA	181

ALI PODRIMJA

VEPRA

Vëllimi i parë

Prishtinë, 2013

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Design: ZENI BALLAZHI

Radhitja & faqësja: BURIM REXHEPI

Lektor & korrektor: SHEFQET RIZA

Madhësia: 12.18 tabakë shtypi

Tirazhi: 500 kopje

Formati A5 (14.8 x 21 cm)

Shtypi: FOCUS-PRINT, Prishtinë-Shkup

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-1

Podrimja, Ali

Vepra = Works / Ali Podrimja. - Prishtina : Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2013. - libra ; 21cm.

Vëllimi 1 : Thirrje (1961) ; Thirrje(1973) ; Shamia e përshëndetjeve - 195 f., portreti i autorit

Një zë thellësisht.../ Ali Aliu : f. 7-24 – Biografia : f. 181-190

ISBN 978-9951-615-14-3

ISBN 978-9951-615-15-0